



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.66

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9548 datë 1.6.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve.....	1819
Ligj nr.9549 datë 1.6.2006	Për ratifikimin e “marrëveshjes së grantit të objektivit strategjik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit”.....	1838
Vendim i Kuvendit nr.42, datë 19.6.2006	Për emërimin e Kryetarit të Bordit të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike.....	1851
Vendim i Kuvendit nr.43, datë 19.6.2006	Për largimin nga detyra të anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës.....	1851
Vendim i Kuvendit nr.44, datë 19.6.2006	Për moslargimin nga detyra të një anëtari të Komisionit të Konkurrencës.....	1852
Vendim i KM nr.382, datë 14.6.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	1852
Vendim i KM nr.384, datë 14.6.2006	Për lejimin e hyrjes dhe të qëndrimit të përkohshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë të trupave britanike, pjesëmarrëse në stërvitjen e përbashkët “Albania Express 06”	1853
Vendim i KM nr.385, datë 14.6.2006	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për hapjen e pikës së re të kalimit kufitar rrugor	

ndërkombëtar, midis dy vendeve Xhepisht- Trebisht.....	1854
.....	

L I G J
Nr.9548, datë 1.6.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN PËR REGJISTRAT E SHKARKIMIT DHE TË TRANSFERIMIT TË NDOTËSVE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin për Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4928, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PROTOKOLL

MBI REGJISTRAT E SHKARKIMIT DHE TRANSFERIMIT TË NDOTËSVE I KONVENTËS SË AARHUS
MBI TË DREJTËN E INFORMIMIT, PJESËMARRJEN E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE, SI DHE TË DREJTËN E TIJ PËR T'JU DREJTUAR GJYKATËS PËR PROBLEMET MJEDISORE

Palët e këtij Protokolli,

duke kujtuar nenin 5 paragrafi 9 dhe nenin 10 paragrafi 2 të Konventës së vitit 1998 mbi të drejtën e informimit, pjesëmarrjen publike në vendimmarrje dhe drejtësinë lidhur me problemet mjedisore (Konventa Aarhus);

duke ditur se regjistrat e shkarkimit dhe transportimit të ndotësve sigurojnë një mekanizëm të rëndësishëm për rritjen e përgjegjshmërisë së përbashkët, uljen e ndotjes dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, sikurse thuhet në Deklaratën Lucca të miratuar në takimin e parë të palëve në Konventën Aarhus;

duke pasur parasysh nenin 10 të Deklaratës së Rios të vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin;

duke pasur parasysh gjithashtu parimet dhe detyrimet e rëna dakord gjatë Konferencës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, në veçanti dispozitat në kapitullin 19 të agjendës 21;

duke i kushtuar vëmendje programit për zbatimin e mëtejshëm të agjendës 21, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në sesionin e nëntëmbëdhjetë special të saj në vitin 1997, në të cilën u bë thirrje për nxitje të kapaciteteve dhe aftësive kombëtare në mbledhjen, përpunimin dhe shpërhapjen e informacionit, për mundësimin e së drejtës për t'u informuar mbi çështjet mjedisore nëpërmjet mjeteve të duhura;

duke i kushtuar vëmendje planit të zbatimit të Samitit Botëror të vitit 2002 mbi zhvillimin e qëndrueshëm, i cili mbështet zhvillimin e informacionit bashkëkohor e të integruar mbi elementet kimike, sikurse nëpërmjet regjistrave kombëtare të shkarkimit dhe transportimit të ndotësve;

duke pasur parasysh punën e Forumit Ndërqeveritar mbi Sigurinë e Substancave Kimike, veçanërisht Deklaratën e Bahias të vitit 2002 mbi Sigurinë e Substancave Kimike, Përparësitë e veprimit pas vitit 2000 dhe Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve/Planin e Veprimit për Inventarin e Shkarkimeve;

duke pasur parasysh gjithashtu veprimtaritë e ndërmarra në kuadër të Programit Ndëroorganizacional për Menaxhimin e Fortë të Substancave Kimike;

duke pasur parasysh për më tepër punën e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, në veçanti Këshillin e Rekomandimit të saj për Vënien në Veprim të Regjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve, në të cilin Këshilli thërret vendet anëtare të krijojnë dhe të bëjnë të mundur publikisht regjistrat kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve;

duke dashur të sigurohet një mekanizëm i cili do të bëjë të mundur që çdo individ i brezave të sotshëm dhe të ardhshëm të jetojë në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, duke garantuar progresin e sistemeve të hapura të informacionit mjedisor;

duke dashur gjithashtu të sigurohemi se zhvillimi i këtyre sistemeve merr parasysh parimet, që ndihmojnë një zhvillim të qëndrueshëm, siç është metoda parandaluese e vendosur në parimin 15 të Deklaratës së Rios së vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin;

duke ditur lidhjen midis sistemeve adekuate të informacionit mjedisor dhe ushtrimin e të drejtave që përmbahen në Konventën Aarhus;

duke parë nevojën për bashkëpunim me nisma të tjera ndërkombëtare lidhur me ndotjet dhe mbeturinat, duke përfshirë këtu Konventën e Stokholmit të vitit 2001 mbi Mbetjet Organike të Vazhdueshme dhe Konventën e Bazelit të vitit 1989 mbi Kontrollin e Lëvizjeve Transkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Eliminimit të tyre;

duke pranuar se objektivat e një metode të integruar për minimizimin e ndotjes dhe sasisë së mbetjeve, që rezultojnë pas veprimit të instalimeve industriale dhe burimeve të tjera, janë arritja e një niveli të lartë mbrojtjeje të mjedisit në tërësi, ecja drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe të fortë nga pikëpamja mjedisore dhe mbrojtja e shëndetit të brezave të sotëm dhe të ardhshëm;

duke qenë të bindur për vlerën e regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve si një mjet me kosto efektive për nxitjen e përmirësimeve në performancën mjedisore, për sigurimin e aksesit publik në informacionin mbi shkarkimin e ndotësve dhe transferimin e tyre në dhe ndërmjet komuniteteve, si dhe për përdorim nga ana e qeverive në ndjekjen e trendeve, shprehjen e progresit në uljen e nivelit të ndotjes, kontrollin e përputhjes me marrëveshje të caktuara ndërkombëtare, vendosjen e përparësive dhe vlerësimin e progresit të arritur përmes politikave dhe programeve mjedisore;

duke marrë parasysh se regjistrat e shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve mund të sjellin përfitime të prekshme për industrinë nëpërmjet menaxhimit të përmirësuar të ndotësve;

duke vënë re mundësitë për përdorimin e të dhënave në regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, të kombinuara me informacionin shëndetësor, mjedisor, demografik, ekonomik apo të tjera informacione të rëndësishme, me qëllim arritjen e një mirëkuptimi më të mirë të problemeve të mundshme, identifikimin e “pikave të nxehta”, marrjen e masave parandaluese dhe shpjeguese dhe vendosjen e përparësive të menaxhimit mjedisor;

duke pranuar rëndësinë e ruajtjes së fshehtësisë së personave fizikë të identifikuar apo të identifikueshëm në përpunimin e informacionit të raportuar në regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, në përputhje me standardet e aplikueshme ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të dhënave;

duke pranuar gjithashtu rëndësinë e zhvillimit të sistemit të regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve, të pajtueshëm në nivel ndërkombëtar, për rritjen e krahasueshmërisë së të dhënave;

duke parë se shumë shtete anëtare të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën, Komunitetin Europian dhe palët e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut po punojnë për mbledhjen e të dhënave për shkarkimin dhe transferimin e ndotjeve nga burime të ndryshme dhe për t'i bërë ato gjerësisht të mundshme, si dhe duke pranuar veçanërisht për këtë zonë përvojën e gjatë dhe të vlefshme të disa vendeve;

duke marrë në konsideratë përafrime të ndryshme për regjistrat ekzistues të shkarkimit dhe rëndësinë e shmangies së përsëritjeve, duke pranuar në këtë mënyrë nevojën e një shkalle të caktuar fleksibiliteti;

duke nxitur zhvillimin progresiv të regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve;

duke nxitur gjithashtu vendosjen e lidhjeve midis regjistrave kombëtare të shkarkimit, dhe transferimit të ndotjeve dhe sistemeve të informacionit mbi të tjera shkarkime të interesit publik,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Objektivi

Objektivi i këtij Protokolli është rritja e mundësisë publike për informacion, nëpërmjet krijimit të regjistrave bashkëkohorë, gjithëpërfshirës dhe kombëtar të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (PRTR), në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli, që do të lehtësojë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, si dhe ndihmon në parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllimet e këtij Protokolli,

1. “Palë” nënkupton, veç kur teksti shprehet ndryshe, një shtet ose një organizatë rajonale të integritit ekonomik të përmendur në nenin 24, që ka rënë dakord të preket nga ky Protokoll dhe në të cilin Protokollin është në fuqi.

2. “Konventë” nënkupton Konventën e të drejtës së informimit, pjesëmarrjes publike në vendimmarrje dhe drejtësisë lidhur me problemet mjedisore, e përgatitur në Aarhus, Danimarkë, në 25 qershor 1998.

3. “Publik” nënkupton një ose më shumë persona fizikë apo juridikë dhe në përputhje me legjislacionin apo praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat apo grupet e tyre.

4. “Shërbim” nënkupton një ose më shumë instalime në të njëjtin vend, ose në vendet fqinje, që zotërohen apo punohen nga i njëjti person fizik ose juridik.

5. “Autoriteti kompetent” nënkupton autoritetin apo autoritetet kombëtare, apo ndonjë organ apo organe të tjera kompetente, të ngritura nga një palë për të menaxhuar një sistem të regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve.

6. “Ndotës” nënkupton një substancë ose grup substancash, që mund të jenë të dëmshme për mjedisin ose shëndetin e njerëzve, në kurriz të zotërimeve të tij dhe ndikimit të tij në mjedis.

7. “Çlirim” nënkupton çdo futje të ndotësve në mjedis si rezultat i veprimtarisë njerëzore, qoftë e qëllimshme apo jo, e zakonshme apo jo, përfshirë derdhjen, rrezatimin, shkarkimin, futjen, shfrytëzimin apo *dumping*, apo nëpërmjet sistemeve të ujërave të zeza pa trajtimin përfundimtar të mbeturinave ujore.

8. “Transferimi përtej vendit” nënkupton lëvizjen përtej kufijve të burimit të ndotësve dhe mbeturinave të destinuara për shfrytëzim apo përpunim dhe ndotësve në ujin e ndotur të destinuar për trajtim të këtyre ujërave.

9. “Burime të shpërndara” nënkupton burimet e shumta të vogla dhe të përhapura, prej të cilave mund të shkarkohen ndotësit në tokë, ajër apo ujë impakti i kombinuar i të cilëve në këto zëra mund të jetë i rëndësishëm dhe për të cilët nuk është e arsyeshme mbledhja e raporteve nga çdo burim individual;

10. Termat “kombëtar” dhe “gjithëkombëtar” duhet, duke iu referuar detyrimeve nën Protokollin e palëve që janë organizata të integritit ekonomik, parë sipas vendit në fjalë, veçse kur shprehet ndryshe.

11. “Mbetje” nënkupton substanca apo objekte të cilat:

a) janë hedhur apo përpunuar;

b) do të hidhen apo përpunohen; ose

c) sipas dispozitave të ligjit kombëtar kërkohet të hidhen apo përpunohen;

12. “Mbetje të rrezikshme” do të thotë mbetje të përcaktuara si të rrezikshme nga dispozitat e ligjit kombëtar.

13. “Mbetje të tjera” nënkupton mbetje që nuk janë mbetje të rrezikshme.

14. “Ujë i ndotur” nënkupton ujin që përmban substanca apo objekte që janë subjekt i rregullave të ligjit kombëtar.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

1. Çdo palë duhet të ndërmarrë masat e nevojshme legislative, rregullatore dhe të tjera dhe masat e duhura zbatuese për të vënë në veprim dispozitat e këtij Protokoll.

2. Dispozitat e këtij Protokollin nuk duhet të prekin të drejtën e një pale për të mirëmbajtur apo paraqitur një regjistër të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve më përfshirës ose me akses më të madh në publik, të kërkuar nga ky Protokoll.

3. Çdo palë duhet të marrë masat e nevojshme, që punonjësit e një shërbimi dhe pjesëtarët e publikut, që raportojnë një shkelje tek autoritetet publike nga ana e një shërbimi të ligjeve kombëtare, duke zbatuar këtë Protokoll, të mos penalizohen, ndiqen apo shqetësohen nga ky shërbim apo autoritet publike për veprimet e tyre në raportimin e shkeljes.

4. Në zbatimin e këtij Protokollin, çdo palë do të udhëzohet nga metoda parandaluese e caktuar në parimin 15 të Deklaratës së Rios të vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin.

5. Për të reduktuar raportimet e përsëritura, sistemet e regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve mund të përfshihen në një masë të arsyeshme në burimet ekzistuese të informacionit, siç janë mekanizmat e raportimit sipas licencave ose lejet e veprimit.

6. Palët duhet të përpiqen të arrijnë konvergjencë përgjatë regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve.

Neni 4

Elementet kyç të sistemit të regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve

Sipas këtij Protokollin, çdo palë duhet të krijojë dhe mirëmbajë një regjistër kombëtar të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve më të mundshëm në publik, i cili:

a) është shërbim specifik për të përkrahur raportimin mbi burimet;

- b) ndihmon raportimin mbi burimet e shpërndara;
- c) është ndotës specifik apo mbetje-specifik, sipas rastit;
- d) është multimedia, duke bërë dallimin midis shkarkimeve në ajër, tokë, dhe ujë;
- e) përfshin informacion mbi transferimet;
- f) bazohet në raportim të detyrueshëm mbi bazë periodike;
- g) përfshin të dhëna të standardizuara dhe në afat kohor, një numër të kufizuar pragjesh të standardizuara të raportimit dhe dispozita të kufizuara, nëse ka, për arsye fshehtësie (privacy);
- h) është bashkëkohor dhe i hartuar për të qenë përdorues-miqësor dhe publikisht i mundshëm, edhe në formë elektronike;
- i) lejon pjesëmarrjen publike në zhvillimin dhe ndryshimin e tij; dhe
- j) është një *data base* të dhënash e strukturuar, kompjuterizuar ose *data base* të lidhura të ndryshme, të mbajtura nga autoriteti kompetent.

Neni 5

Hartimi dhe struktura

1. Çdo palë do të sigurojë që të dhënat e zotëruara në regjistër, lidhur me nenin 4, të paraqiten në formularë përmbljedhës dhe jo përmbljedhës, në mënyrë që shkarkimet dhe transferimet të mund të kërkojnë dhe identifikohen sipas:

- a) shërbimit dhe vendosjes gjeografike të tij;
- b) veprimtarisë;
- c) pronarit ose operatorit dhe, kur duhet, kompanisë;
- d) ndotësit apo mbetjes, si të jetë e përshtatshme;
- e) secilit prej zërave mjedisorë në të cilin shkarkohet ndotësi; dhe
- f) sikurse specifikohet në nenin 7 paragrafi 5, destinacionit të transferimit dhe, aty ku duhet, shfrytëzimit apo përpunimit të mbeturinave.

2. Çdo palë duhet të sigurojë gjithashtu që të dhënat të mund të kërkojnë dhe identifikohen sipas këtyre burimeve të shpërndara, të përfshira në regjistër.

3. Çdo palë duhet të hartojë regjistrin e saj, duke marrë parasysh mundësinë e zgjerimit të ardhshëm të saj dhe duke siguruar se, të dhënat raportuese, të paktën që prej 10 viteve të fundit të raportimit, të jenë publikisht të mundshme.

4. Regjistri duhet të hartohet për një lehtësi maksimale të aksesit publik nëpërmjet mjeteve elektronike, siç ishte interneti. Hartimi duhet të lejojë që, në kushte normale pune, informacioni i regjistrin të jetë i mundshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe të menjëhershme nëpërmjet mjeteve elektronike.

5. Çdo palë duhet të ofrojë lidhje në regjistrin e saj me *data base*-at e duhura ekzistuese dhe publikisht të mundshme, lidhur me çështjet e mbrojtjes së mjedisit.

6. Çdo palë duhet të ofrojë lidhje në regjistrin e saj me regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve të palëve të tjera në Protokoll dhe, aty ku është e mundur, me ato të vendeve të tjera.

Neni 6

Qëllimi i regjistrin

1. Çdo palë duhet të sigurojë që regjistri i saj të përmbajë informacion mbi:

- a) shkarkimet e ndotësve, që duhen raportuar sipas nenit 7 paragrafi 2;
- b) transferimet përtej vendit, që duhen raportuar sipas nenit 7 paragrafi 2; dhe
- c) shkarkimet e ndotësve nga burimet e shpërndara, sipas nenit 7 paragrafi 4.

2. Duke vlerësuar përvojën e fituar nga hartimi i regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve dhe zbatimin e këtij Protokoll dhe duke marrë parasysh procese të rëndësishme ndërkombëtare, takimi i palëve do të rishohë kërkesat raportuese të këtij Protokoll dhe do të konsiderojë çështjet e mëposhtme gjatë zhvillimit të mëtejshëm të tij:

- a) Rishikim i veprimtarive të specifikuara në shtojcën I;
- b) Rishikim i ndotësve të specifikuar në shtojcën II;
- c) Rishikim i pragjeve në shtojcat I dhe II; dhe
- d) Përfshirje e aspekteve të tjera të rëndësishme siç është informacioni mbi transferimet në vend, magazinimin, specifikimin e kërkesave raportuese për burimet e shpërndara apo zhvillimin e kriterit për përfshirjen e ndotësve nën këtë Protokoll.

Neni 7

Kërkesat e raportimit

1. Çdo palë duhet gjithashtu:

a) t'i kërkojë zotëruesit ose operatorit të çdo shërbimi individual brenda juridiksionit të tij që të ndërmarrë një ose më shumë nga veprimtaritë e specifikuar në shtojcën 1 mbi pragjet e zbatueshme të kapacitetit, të specifikuar në shtojcën I kolona 1, dhe:

i) të shkarkojë çdo ndotës të specifikuar në shtojcën II në sasi që e kalojnë prapun e zbatueshëm të specifikuar në shtojcën II kolona 1;

ii) të transferojnë përtej vendit çdo ndotës të specifikuar në shtojcën II, në sasi që e kalojnë prapun e zbatueshëm të specifikuar në shtojcën II kolona 2, ku pala ka vendosur për raportim specifik sipas ndotësve të transferimeve në vijim të paragrafit 5(d);

iii) të transferojë përtej vendit mbetje të rrezikshme që kalojnë sasinë 2 ton/vit ose mbetje të tjera, që kalojnë sasinë 2,000 ton/vit, ku pala ka vendosur për raportimin specifik sipas mbetjeve të transferimeve në vijim të paragrafit 5(d); ose

iv) të transferojë përtej vendit çdo ndotës të specifikuar në shtojcën II në ujërat e ndotur të destinuar për trajtimin e tyre, në sasi që kalojnë prapun e zbatueshëm, të specifikuar në shtojcën II kolona 1b;

Të marrë përsipër detyrimin e vënë mbi atë zotërues ose operator në vijim të paragrafit 2; ose

b) të kërkojë zotëruesin ose operatorin e çdo shërbimi individual brenda juridiksionit të tij, që ndërmerr një ose më shumë nga veprimtaritë e specifikuar në shtojcën I, në apo mbi prapun e punësimit të treguar në shtojcën I kolona 2 dhe që prodhon, përpunon apo përdor çdo ndotës të specifikuar në shtojcën II, në sasi që kalojnë prapun e zbatueshëm të treguar në shtojcën II kolona 3, të marrë përsipër detyrimin që i është ngarkuar këtij zotëruesi apo operatori në vijim të paragrafit 2.

2. Çdo palë duhet t'i kërkojë zotëruesit apo operatorit të një shërbimi, të përmendur në paragrafin 1, të paraqesë informacionin e specifikuar në paragrafët 5 dhe 6 dhe në përputhje me kërkesat në to, lidhur me ata ndotës dhe mbetje që kanë kaluar nivelin prag.

3. Në mënyrë që të arrihet objektivi i këtij protokollit, një palë mund të vendosë lidhur me një ndotës të veçantë të zbatojë edhe një prag shkarkimi apo prag prodhimi, përpunimi ose përdorimi, në mënyrë që kjo të rrisë informacionin e lidhur me shkarkimet apo transferimet e pasqyruara në këtë regjistër.

4. Çdo palë duhet të sigurojë që autoriteti kompetent i saj të mbledhë ose të krijojë një ose më shumë autoritete publike apo organe kompetente për të mbledhur informacion mbi shkarkimin e ndotësve nga burimet e shpërndara, të specifikuar në paragrafët 7 dhe 8, për t'u përfshirë në këtë regjistër.

5. Çdo palë duhet t'i kërkojë zotëruesve apo operatorëve të shërbimeve, të raportojnë sipas paragrafit 2 për të përfunduar dhe paraqitur para autoritetit kompetent të saj informacionin e mëposhtëm në baza specifike shërbimi:

a) emri, adresa e rrugës, vendosja gjeografike dhe veprimtaria apo veprimtaritë e shërbimit raportues dhe emrin e zotëruesit ose operatorit dhe, nëse duhet të kompanisë;

b) emri dhe identifikimin numerik të çdo ndotësi, i kërkuar për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2;

c) sasinë e çdo ndotësi, për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2, të shkarkuar nga shërbimi në mjedis në vitin raportues, në përgjithësi dhe sipas vendit të shkarkimit në ajër, ujë apo tokë, sikurse dhe nga injektimi ndërtokësor;

d) Gjithashtu:

i) sasinë e çdo ndotësi për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2 të transferuar përtej vendit në vitin raportues, duke bërë dallim midis sasive të transferuara për shfrytëzim dhe përpunim dhe emrin dhe adresën e shërbimit që e merr këtë transport; ose

ii) sasinë e mbetjeve për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2 të transferuar përtej vendit në vitin raportues, duke bërë dallimin midis mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera, për çdo veprim përpunimi apo shfrytëzimi, të treguar respektivisht me "R ose D", nëse mbetjet janë të destinuara për shfrytëzim ose përpunim sipas shtojcës III dhe për lëvizje transkufitare të mbetjeve të rrezikshme, emrin dhe adresën e shfrytëzuesit apo përpunuesit të mbetjeve dhe vendndodhjen aktuale të atyre që presin transferimin;

e) sasia e çdo ndotësi në ujë të ndotur, për t'u raportuar në vijim të paragrafit 2, të transferuar përtej vendit në vitin raportues; dhe

f) llojin e metodologjisë së përdorur për marrjen e informacionit të përmendur në nënparagrafët c) dhe e) të nenit 9 paragrafi 2, që tregojnë nëse informacioni është bazuar në matje, llogaritje, apo vlerësim.

6. Informacioni i përmendur në paragrafin 5 (c) dhe (d) do të përfshijë informacion mbi shkarkimet dhe transferimet, që vijnë si rrjedhojë e veprimtarive të zakonshme dhe prej ngjarjeve të jashtëzakonshme.

7. Çdo palë do të paraqesë në regjistrin e saj, në një hapësirë të veçantë të mjaftueshme, informacion mbi shkarkimet e ndotësve që vijnë nga burimet e shpërndara, për të cilët kjo palë shprehet se të dhënat janë marrë nga autoritetet përkatëse dhe mund të përfshihen në të. Në rastin kur pala arrin në përfundimin se këto të dhëna nuk ekzistojnë, ajo duhet të marrë masa për fillimin e raportimit mbi shkarkimin e ndotësve përkatës nga një apo më shumë burime të shpërndara, në përputhje me përparësitë kombëtare të saj.

8. Informacioni i paraqitur në paragrafin 7 duhet të japë të dhëna mbi llojin e metodologjisë së përdorur

për marrjen e informacionit.

Neni 8

Cikli i raportimit

1. Çdo palë duhet të sigurojë se informacioni për t'u përfshirë në këtë regjistër ka akses publik, është i grumbulluar dhe paraqitur në regjistër sipas vitit kalendarik. Viti raportues është viti kalendarik me të cilin lidhet informacioni i dhënë. Për çdo palë, viti i parë i raportimit është ai vit kalendarik pas të cilit hyn në fuqi Protokoli për atë palë. Raportimi i kërkuar sipas nenit 7 duhet të jetë vjetor. Viti i dytë i raportimit do të ishte viti i dytë kalendarik pas viti të parë të raportimit.

2. Çdo palë, që nuk është një organizatë rajonale e integritit ekonomik, duhet të sigurojë se informacioni është i përfshirë në regjistrin e saj brenda 15 muajve, që prej fundit të çdo viti raportues. Ndërkohë, informacioni për vitin e parë raportues duhet përfshirë në regjistër brenda dy viteve që prej mbarimit të atij viti raportues.

3. Çdo palë, që është një organizatë rajonale integrimi ekonomik, duhet të sigurojë që informacioni për një vit raportimi specifik të jetë përfshirë në regjistër 6 muaj pasi palëve, që nuk janë organizata rajonale të integritit ekonomik, u kërkohet të bëjnë të njëjtën gjë.

Neni 9

Mbledhja e të dhënave dhe ruajtja e tyre

1. Çdo palë duhet t'u kërkojë zotëruesve apo operatorëve të shërbimit, që janë subjekt i raportimit sipas nenit 7, të mbledhin të dhëna, të cilat janë të nevojshme për të përcaktuar, në përputhje me paragrafin 2 më poshtë dhe sipas frekuencës përkatëse, shkarkimet e shërbimit dhe transferimet përtej vendit, si subjekt raportimi sipas nenit 7 dhe të bëjë të mundshme për autoritetet kompetente regjistrimet e të dhënave, prej të cilave është marrë informacioni i raportuar për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që prej fundit të vitit raportues të interesuar. Këto regjistrime duhet të përshkruajnë gjithashtu metodologjinë e përdorur për mbledhjen e të dhënave.

2. Çdo palë duhet t'u kërkojë zotëruesve apo operatorëve të shërbimit, që janë subjekt i raportimit sipas nenit 7, të përdorin informacionin më të mirë të mundshëm, që mund të përfshijë të dhëna monitoruese, faktorët e emetimit, ekuacionet e ekuilibrit të masave, monitorimin e tërthortë apo llogaritje të tjera, vlerësimet inxhinierike dhe metoda të tjera. Ashtu siç duhet, e gjitha kjo duhet bërë në përputhje me metodologjitë e miratuara ndërkombëtare.

Neni 10

Vlerësimi i cilësisë

1. Çdo palë duhet t'u kërkojë zotëruesve ose operatorëve të shërbimit, që janë subjekt i raportimit sipas nenit 7 paragrafi 1, të sigurojnë cilësinë e informacionit që ata raportojnë.

2. Çdo palë duhet të sigurojë që të dhënat e përfshira në këtë regjistër të jenë subjekt i analizës cilësore nga autoriteti kompetent, në veçanti për plotësinë e tyre, rregullsinë dhe besueshmërinë, duke marrë parasysh çdo udhëzues që mund të hartohet nga takimi i palëve.

Neni 11

E drejta publike në informacion

1. Çdo palë duhet të sigurojë aksesin publik të informacionit të përfshirë në regjistrin e saj të shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve, pa nevojën e shprehjes së interesit dhe sipas dispozitave të këtij Protokoli, fillimisht duke garantuar që regjistri i saj të sigurojë akses të drejtpërdrejtë elektronik përmes rrjeteve të telekomunikacionit publik.

2. Në rastet kur informacioni i përfshirë në këtë regjistër nuk është lehtësisht i mundshëm nëpërmjet mjeteve elektronike, çdo palë duhet të sigurojë që autoriteti kompetent i saj, sipas kërkesës, të ofrojë atë informacion nëpërmjet çdo mënyre tjetër efektive, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të shumtën një muaj pas marrjes së kërkesës.

3. Sipas paragrafit 4, çdo palë duhet të sigurojë që aksesin në informacionin që përmban regjistri i saj të jetë falas.

4. Çdo palë mund të lejojë autoritetin kompetent të saj të vendosë një pagesë për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit specifik në vijim të paragrafit 2, por kjo pagesë nuk duhet të kalojë një shumë të caktuar.

5. Në rastet kur informacioni që përmban ky regjistër nuk është lehtësisht i mundshëm nëpërmjet mjeteve të drejtpërdrejta elektronike, çdo palë duhet të lehtësojë mbërritshmërinë elektronike të regjistrit të saj nëpërmjet mjeteve gjerësisht të mundshme, si libraritë publike, zyrat e autoriteteve lokale ose vende të tjera të përshtatshme.

Neni 12 **Konfidencialiteti**

1. Çdo palë mund të autorizojë autoritetin kompetent të ruajë konfidencialitetin e informacionit të mbajtur në regjistër, nëse transmetimi publik i këtij informacioni do të prekte në të kundërt:

- a) marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare ose sigurinë publike;
- b) drejtësinë, mundësinë e një personi të kishte një gjykim të drejtë ose mundësinë e një autoriteti publik të drejtonte një hetim të natyrës kriminale ose disiplinor;
- c) konfidencialitetin e informacionit komercial dhe industrial, në rastet kur ai është i mbrojtur me ligj, në mënyrë që të mbrohet interesi ekonomik legjitim;
- d) të drejtat e pronësisë intelektuale; ose
- e) konfidencialitetin e të dhënave personale dhe/ose dosjeve të një personi fizik, nëse ky person nuk është dakord me bërjen publike të këtij informacioni, kur ky konfidencialitet sigurohet në ligjin kombëtar.

Bazat e sipërpërmendura për konfidencialitetin duhen interpretuar në mënyrë të kufizuar, duke marrë parasysh interesin publik të cilit i shërben ky transmetim i informacionit dhe nëse informacioni lidhet me shkarkimet në mjedis.

2. Në kuadër të paragrafit 1(c), çdo informacion mbi shkarkimet, i cili është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, duhet zbuluar sipas ligjit kombëtar.

3. Në çdo rast që informacioni mbahet konfidencial sipas paragrafit 1, regjistri duhet të tregojë llojin e informacionit të mbajtur, përmes p.sh. ofrimit të informacionit të përgjithshëm kimik, nëse është i mundshëm, dhe për çfarë arsyes është ndërprerë.

Neni 13 **Pjesëmarrja publike në hartimin e regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve**

1. Çdo palë duhet të ofrojë mundësitë e duhura për pjesëmarrjen publike në hartimin e regjistrit të saj kombëtar për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve, në kuadër të ligjit kombëtar të saj.

2. Sipas paragrafit 1, çdo palë duhet të ofrojë mundësinë për akses të lirë publik në informacion mbi masat e propozuara lidhur me hartimin e regjistrit kombëtar të saj për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve dhe për pranimin e çdo komenti, informacioni, analize apo opinion, që janë të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes dhe autoriteti përkatës duhet të japë shpjegimin e duhur për këtë input publik.

3. Çdo palë duhet të sigurojë se, kur është ndërmarrë një vendim për të krijuar apo për të ndryshuar rrënjësisht regjistrin e tij, informacioni mbi vendimin dhe konsideratat mbi të cilat ai është bazuar janë bërë publike sipas një kalendari kohor.

Neni 14 **Akresi në drejtësi**

1. Çdo palë duhet, në kuadër të legjislacionit kombëtar të saj, të sigurojë se çdo person, që mendon se kërkesa e tij për informacion sipas nenit 11 paragrafi 2 nuk është marrë parasysh, është refuzuar gabimisht, pjesërisht ose plotësisht, nuk është përgjigjur në mënyrë të përshtatshme ose, në të kundërt, nuk është trajtuar sipas dispozitave të këtij paragrafi, të ketë të drejtë të rishikojë procedurën përpara një gjykate ose organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuara me ligj.

2. Kërkesat në paragrafin 1 nuk kanë anshmëri ndaj të drejtave dhe detyrimeve respektive të palëve nën marrëveshjet ekzistuese të zbatueshme midis tyre dhe që kanë të bëjnë me temën e këtij neni.

Neni 15 **Formimi i aftësive**

1. Çdo palë duhet të nxisë ndërgjegjësimin publik mbi regjistrin e saj të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve dhe duhet të sigurojë se për akses në regjistrin e saj, si dhe për të kuptuar dhe përdorur informacionin e përfshirë në të, ofrohet ndihmë dhe udhëzim.

2. Çdo palë duhet të ofrojë formim të duhur të aftësive dhe udhëheqjen e duhur drejt autoriteteve dhe

organeve përgjegjës në ndihmë të tyre për kryerjen e duhur të detyrave sipas këtij Protokolli.

Neni 16

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Palët duhet të bashkëveprojnë dhe të ndihmojnë njëra-tjetrën:
 - a) Në veprimet ndërkombëtare në ndihmë të objektivave të këtij Protokolli;
 - b) Në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta midis palëve të interesuara, në zbatimin e sistemeve kombëtare në vijim të këtij Protokolli;
 - c) Në ndarjen e informacionit të këtij Protokolli mbi shkarkimet dhe transferimet brenda zonave kufitare; dhe
 - d) Në ndarjen e informacionit të këtij Protokolli lidhur me transferimet ndërmjet palëve.
2. Palët duhet të nxisin bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe organizatave ndërkombëtare përkatëse, siç përcaktohet, për të nxitur:
 - a) ndërgjegjësimin publik në nivel ndërkombëtar;
 - b) transferimin e teknologjisë; dhe
 - c) ofrimin e asistencës teknike ndaj palëve që janë vende në zhvillim dhe palëve me ekonomi në tranzicion, lidhur me çështjet e këtij Protokolli.

Neni 17

Takimi i palëve

1. Një takim i palëve bëhet në këtë mënyrë. Sesioni i tij i parë duhet thirrur jo më vonë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli. Që prej këtij momenti, do të mbahen sesione të zakonshme të takimit të palëve në vazhdim ose paralel me takimet e zakonshme të palëve në konventë, përveçse kur vendoset ndryshe nga palët në këtë Protokoll. Takimi i palëve duhet të mbajë një sesion të jashtëzakonshëm nëse vendoset kështu gjatë punës së një sesioni të zakonshëm ose në kërkesën e shkruar të çdo pale duke siguruar që, brenda 6 muajve pas komunikimit të saj të gjitha palët nga Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik të Europës, kërkesa e bërë të mbështetet nga të paktën 1/3 e këtyre palëve.
2. Takimi palëve duhet të mbajë nën vëzhgim të vazhdueshëm zbatimin dhe hartimin e këtij Protokolli mbi bazë të një raportimi të rregullt nga ana e palëve dhe duke pasur këtë qëllim parasysh, duhet:
 - a) të rishohë hartimin e regjistrave të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve dhe të nxisë fuqizimin dhe konvergjencën progresive të tyre;
 - b) të krijojë udhëzues që të lehtësojnë raportimin e palëve në të, duke mbajtur parasysh nevojën për të shmangur përsëritjen e përpjekjeve në këtë drejtim;
 - c) të vendosë një program pune;
 - d) të marrë parasysh dhe, aty ku duhet, të adoptojë masa për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në përputhje me nenin 16;
 - e) të krijojë aq organe ndihmëse sa të mendojë të nevojshëm;
 - f) të konsiderojë dhe aprovojë propozime për amendamente të tilla të këtij Protokolli dhe shtojcave të tij, si të shihet e nevojshme për qëllimet e këtij Protokolli, në përputhje me dispozitat e nenit 20;
 - g) në sesionin e tij të parë, të marrë parasysh dhe me konsensus të vendosë rregullat e procedurës për sesionet e tij dhe ato të organeve ndihmëse të tij, duke marrë parasysh çdo rregull procedure të miratuar nga Takimi i Palëve në Konventë;
 - h) të vlerësojë krijimin e marrëveshjeve financiare me konsensus dhe mekanizmat e ndihmës teknike për të lehtësuar zbatimin e këtij Protokolli;

- i) të kërkojë, aty ku duhet, shërbimet e organeve të tjera përkatëse ndërkombëtare për arritjen e objektivave të këtij Protokolli; dhe
 - j) të vlerësojë dhe të ndërmarrë ndonjë veprim shtesë që mund të kërkojë për çuarjen përpara të objektivave të këtij Protokolli, sikurse është miratimi udhëzuesve dhe rekomandimeve, që nxisin zbatimin e tij.
3. Takimi palëve duhet të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mbi përvojën e fituar në raportimin e transferimeve duke përdorur metodat ndotës-specifik dhe mbetje-specifik dhe duhet të rishohë këtë përvojë, në mënyrë që të hetohet mundësia e konvergjencës midis dy metodave, duke mbajtur parasysh interesin publik për informacion në përputhje me nenin 1 dhe efektivitetin e përgjithshëm të regjistrave kombëtarë të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve.

4. Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara të tyre dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, sikurse dhe çdo organizatë shtetërore apo rajonale e integritit ekonomik, që i është dhënë e drejta sipas nenit 24 për të nënshkruar këtë Protokoll, por që nuk është palë në të dhe çdo organizatë ndërqeveritare e

specializuar në fushat në të cilat shtrihet Protokollin, duhet mundësuar të marrë pjesë si vëzhgues në takimin e palëve. E drejta për të hyrë dhe pjesëmarrja duhet t'i nënshtrohet rregullave dhe procedurave të rëna dakord në takimin e palëve.

5. Çdo organizatë joqeveritare e specializuar në fushat e këtij Protokollin, që ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Ekonomik për Europën për dëshirën e saj për t'u përfaqësuar në një sesion të takimit të palëve do të caktohet të marrë pjesë si një vëzhgues, përveçse kur 1/3 e palëve të pranishme në sesionin proteston. E drejta për të hyrë dhe pjesëmarrja e tyre do t'i nënshtrohet rregullave procedurale të miratuara nga takimi i palëve.

Neni 18

E drejta për të votuar

1. Me përjashtim të rastit siç tregohet në paragrafin 2, çdo palë e këtij Protokollin do të ketë një votë.
2. Organizatat rajonale për integrim ekonomik, për çështje brenda kompetencës së tyre, do të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare të tyre, që janë palë. Të tilla organizata nuk do të ushtrojnë të drejtën e votës, nëse shtetet anëtare të tyre e ushtrojnë atë dhe e kundërta.

Neni 19

Shtojcat

Shtojcat e këtij Protokollin do të përbëjnë një formë integrale të tillë dhe derisa qartësisht të parashikohet ndryshe, një referencë ndaj këtij Protokollin përbën në të njëjtën kohë një referencë për çdo shtojcë tjetër.

Neni 20

Amendamentet

1. Çdo palë mund të propozojë amendamente për këtë Protokoll.
2. Propozimet për amendamente në këtë Protokoll duhet të vlerësohen në një sesion të takimit të palëve.
3. Çdo amendament i propozuar për këtë Protokoll duhet dorëzuar me shkrim në sekretariat, i cili duhet ta komunikojë atë të paktën 6 muaj para sesionit në të cilin amendamenti i është propozuar gjithë palëve, shteteve të tjera dhe organizatave rajonale të integritit ekonomik, të cilat kanë pranuar të jenë pjesë e Protokollit dhe për të cilat nuk ka hyrë ende në fuqi, si dhe pjesëmarrësve.
4. Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshjet mbi çdo amendament të propozuar me konsensus në këtë Protokoll. Nëse janë bërë të gjitha përpjekjet me konsensus dhe nuk është arritur asnjë marrëveshje, amendamenti, si një mundësi e fundit, duhet miratuar me votën e tre të katërtave të palëve të pranishme dhe votuese në sesion.
5. Sipas këtij neni, "Palët e pranishme dhe votuese" do të thotë palët që janë të pranishme dhe që japin një votë pozitive ose negative.
6. Çdo amendament i këtij Protokollin, miratuar në përputhje me paragrafin 4, duhet komunikuar nga ana e Sekretariatit tek depozitari, i cili duhet t'ia qarkullojë atë të gjitha palëve, shteteve dhe organizatave të tjera rajonale të integritit ekonomik, që kanë pranuar të jenë pjesë e këtij protokollin dhe për të cilat ai s'ka hyrë ende në fuqi, si dhe pjesëmarrësve.
7. Një amendament, një në një shtojcë, duhet të hyjë në fuqi për ato palë që e kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar atë në ditën e nëntëmbëdhjetë pas datës së marrjes nga depozitari i ratifikimit, pranimi ose miratimit nga të paktën tre të katërtat e atyre që ishin palë në kohën e adoptimit të tij. Më tej, ai duhet të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër në ditën e nëntëmbëdhjetë pas datës që ajo palë depoziton instrumentet e saj të ratifikimit, pranimi ose miratimit të amendamentit.
- Në rastin e një amendamenti në një shtojcë, një palë që nuk e pranon një amendament të tillë duhet të njoftojë depozituesin me shkrim brenda dymbëdhjetë muajve nga data e qarkullimit të tij nga ana e depozituesit. Depozituesit duhet të informojë pa vonesë të gjitha palët për çdo njoftim të marrë të këtij lloji. Një palë mundet të tërheqë në çdo kohë një njoftim të mëparshëm për mospranim e, si pasojë, amendamenti i një shtojce duhet të hyjë në fuqi për atë palë.
9. Me skadimin e dymbëdhjetë muajve nga data e qarkullimit të tij nga ana e depozituesit, siç thuhet në paragrafin 6, një amendament në një shtojcë duhet të hyjë në fuqi për ato palë, të cilat nuk kanë dorëzuar një njoftim te depozituesi sipas paragrafit 8, me kusht që në atë kohë jo më shumë se një e treta e atyre që ishin palë në kohën e adoptimit të amendamentit kanë paraqitur një njoftim të tillë.
10. Nëse një amendament i një shtojce është i lidhur drejtpërsëdrejti me një amendament të këtij Protokollin, ai nuk duhet të hyjë në fuqi derisa amendamenti i këtij Protokollin hyn në fuqi.

Neni 21
Sekretariati

Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën duhet të kujdeset për funksionet e mëposhtme sekretariale të këtij Protokoll:

- a) Përgatitjen dhe shërbimin e sesioneve të takimit të palëve;
- b) Kalimin të palët të raporteve dhe informacioneve të tjera të marra në përputhje me dispozitat e këtij Protokoll;
- c) Raportimin në takimin e palëve mbi veprimtaritë e Sekretariatit; dhe
- d) Të tjera funksione që mund të përcaktohen nga takimi i palëve në bazë të burimeve të mundshme.

Neni 22
Rishikimi i përputhshmërisë

Në sesionin e tij të parë, takimi i palëve duhet të vendosë me konsensus procedura mbështetëse dhe marrëveshje institucionale të një natyre jogjyqësore, jokontradiktore dhe këshilluese për të vlerësuar dhe nxitur përputhshmërinë me dispozitat e këtij Protokoll dhe të trajtojë rastet e mospërputhjes. Në vendosjen e këtyre procedurave dhe marrëveshjeve, takimi i palëve duhet të marrë parasysh *inter alia*, nëse duhet lejuar marrja e informacionit nga pjesëtarët e publikut mbi çështjet e lidhura me këtë Protokoll.

Neni 23
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse ndodh një mosmarrëveshje midis dy ose më shumë palëve lidhur me interpretimin ose përdorimin e këtij Protokoll, ato duhet të shohin për një zgjidhje përmes negociatave ose mjeti tjetër paqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të pranueshëm nga ana e palëve në këtë diskutim.

2. Gjatë nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit apo ardhjes në fuqi të këtij Protokoll, apo në çdo kohë të mëpasshme, një shtet mund të deklarojë me shkrim te depozitari se, për një mosmarrëveshje që nuk është zgjidhur në përputhje me paragrafin 1, ai pranon një ose të dy mjetet e mëposhtme për zgjidhjen e debatit, si të detyrueshëm në lidhje me çdo palë që pranon të njëjtin detyrim:

- a) Paraqitjen e mosmarrëveshjes para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë;
- b) Arbitrazhin në përputhje me procedurën e specifikuar në shtojcën IV.

Një organizatë rajonale e integritit ekonomik mund të bëjë një deklaratë me efekt të ngjashëm lidhur me arbitrazhin, në përputhje me procedurat e përmendura në paragrafin e mësipërm (b).

3. Nëse palët në diskutim kanë pranuar të dy mjetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të përmendur në paragrafin 2, mosmarrëveshja mund të paraqitet vetëm para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, veçse nëse palët pjesëmarrëse në debat bien dakord ndryshe.

Neni 24
Nënshkrimi

Ky Protokoll do të nënshkruhet në Kiev (Ukrainë) nga data 21 deri më 23 maj 2003 me rastin e Konferencës së Pestë Ministrore “Mjedis për Europën” dhe më pas në Zyrat Qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork deri më 31 dhjetor 2003, nga të gjitha shtetet që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe nga organizatat rajonale për integritim ekonomik, të përbëra nga anëtarë të shteteve sovranë të Kombeve të Bashkuara, të cilat shtetet anëtare të tyre kanë transferuar kompetencat mbi çështjet e drejtuara nga ky Protokoll, përfshirë dhe kompetencën për të hyrë në tratativa lidhur me këto çështje.

Neni 25
Depozitari

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të veprojë si depozitar i këtij Protokoll.

Neni 26
Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të jetë objekt i ratifikimit, pranimi ose miratimit nga shtetet nënshkruese dhe organizatat rajonale për integrim ekonomik të përmendura në nenin 24.

2. Ky Protokoll do të mund të hyjë në fuqi prej 1 janarit 2004 nga shtetet dhe organizatat rajonale për integrim ekonomik të përmendura në nenin 24.

3. Çdo organizatë rajonale për integrim ekonomik e përmendur në nenin 24, që bëhet palë pa qenë palë asnjë nga shtetet anëtare të saj, do të preket nga gjitha detyrimet e këtij Protokoll. Nëse një apo më shumë shtete anëtare të një organizate të tillë janë palë, organizata dhe shtetet anëtare të saj do të vendosin për përgjegjësitë përkatëse të tyre mbi aftësinë ekzekutuese të detyrimeve të tyre në këtë Protokoll. Në të tilla raste, organizata dhe shtetet anëtare nuk do të lejohen të ushtrojnë të drejta sipas këtij protokoll në të njëjtën kohë.

4. Në instrumentet e tyre për ratifikim, pranim, aprovim apo hyrje në fuqi, organizatat rajonale për integrim ekonomik të përmendura në nenin 24 duhet të deklarojnë shtrirjen e kompetencës së tyre në lidhje me çështjet e drejtuara nga ky Protokoll. Këto organizata duhet, gjithashtu, të informojnë depozitarin për çdo ndryshim të rëndësishëm mbi shtrirjen e kompetencës së tyre.

Neni 27

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitës së instrumentit të gjashtëmbëdhjetë për ratifikim, pranim, aprovim, apo ardhje në fuqi.

2. Në bazë të paragrafit 1, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale për integrim ekonomik, nuk duhet llogaritur si shtesë në ato të depozituara nga shtetet anëtare të një organizate të tillë.

3. Për çdo shtet apo organizatë rajonale për integrim ekonomik që ratifikon, pranon apo aprovon këtë Protokoll, apo, përveç kësaj bie dakord pas depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimi, miratimit apo ardhjes në fuqi, Protokollin do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitës nga ky shtet apo organizatë rajonale për integrim ekonomik të instrumenteve të tij për ratifikim, pranim, aprovim apo ardhje në fuqi.

Neni 28

Rezervat

Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet këtij Protokoll.

Neni 29

Tërheqja

Në çdo moment pas tre vjetësh nga data në të cilën ky Protokoll ka ardhur në fuqi lidhur me një palë, kjo palë mund të tërhiqet nga Protokollin duke bërë një njoftim të shkruar te depozitari. Çdo tërheqje e tillë do të vihet në zbatim në ditën e nëntëdhjetë pas datës së marrjes së tij nga depozitari.

Neni 30

Tekstet autentike

Origjinali i këtij Protokoll, tekstet e të cilit në gjuhën angleze, franceze dhe ruse janë njësoj autentike, do të depozitohen me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar posaçërisht për këtë kanë firmosur këtë Protokoll.

Bërë në Kiev më 21 maj 2003.

SHTOJCA I

N	Aktiviteti	Pragu i kapacitetit (kolona 1)	Pragu i punësimit (Kolona 2)
1	Spektori i energjetikës		
a	Rafineritë minerare të vajit dhe gazit	*	
b	Instalimet për gazifikim dhe lëngëzim	*	10 punonjës
c	Stacionet e fuqisë termale dhe instalimet e djegies	Me një nxehtësi 50 megavat	

		(MW)	
) d	Furrat e koksit	*	
) e	Mullinjtë e qymyrgurit	Me kapacitet 1 ton/orë	
) f	Instalimet për prodhimin e produkteve të qymyrgurit dhe lëndëve të djegshme të ngurta	*	
2 .	Prodhimi dhe përpunimi i metaleve		
) a	Instalimet e xeherorëve (përfshirë sulfidin), pjekjes dhe nxjerrjes së skorieve	*	10 punonjës
) b	Instalimet për prodhimin e kallëpeve të metalit ose çelikut (shkriroje e parë ose e dytë përfshirë derdhjen e vazhdueshme	Me kapacitet 2.5 ton/orë	
) c	Instalimet për përpunimin e metaleve të zeza		
	i) Makinat e petëzimit të nxehtë	Me kapacitet 20 ton çeliku të papërpunuar/orë	
	ii) Kovaçhanat me çekiç	Me energji 50 kiloxhaul për çekiç, ku fuqia kalorifike e përdorur kalon 20 MW	
	iii) Përdorimi i veshjeve mbrojtëse të metaleve të shkriira	Me input 2 ton çeliku të papërpunuar/orë	
) d	Fonderitë e metaleve të zeza	Me kapacitet prodhues 20 ton/ditë	
) e	Instalimet:		
) f	i) Për prodhimin e metaleve jo të zeza të papërpunuara nga koncentratet ose materialet e papërpunuara dytësore nga proceset metalurgjike, kimike ose elektrolitike	*	10 punonjës
	ii) Për shkrijen, përfshirë përzierjen, e metaleve jo të zeza, përfshirë produktet e përmirësuara (rafinimin, fonderinë, derdhjen etj.)	Me kapacitete shkrije prej 4 ton/ditë për plumb dhe kadmium ose 20 ton/ditë për gjithë metalet e tjera	
	Instalime për trajtimin e sipërfaqes së metaleve dhe materialeve plastike, duke përdorur proceset elektrolitike ose kimike	Ku vëllimi i kontenierëve të trajtimit është 30 m ³	
3	Industria minerare		10 punonjës

.			
) a	Punimi mineralar nëntokësor dhe veprimet e ndërlidhura me të	*	
) b	Miniera të hapura	Ku sipërfaqja e zonës së gërmuar është 25 hektar	
) c	Instalimet për prodhimin e:		
	i) Mbetjet e çimentos në furrat rrotulluese	Me një kapacitet prodhimi 500 ton/ditë	
	ii) Gëlqeres në furrat rrotulluese	Me një kapacitet prodhimi që kalon 50 ton/ditë	
	iii) Mbetjet e çimentos dhe gëlqeres në furrat rrotulluese	Me një kapacitet prodhimi prej 50 ton/ditë	
) d	Instalimet për prodhimin e asbestos dhe manifakturimin e produkteve me bazë asbestoje	*	
) e	Instalimet për prodhimin e qelqit, përfshirë fibrat e qelqit	Me një kapacitet shkrirjeje prej 20 ton/ditë	
) f	Instalimet për shkrirjen e substancave minerare, përfshirë prodhimin e fibrave minerare	Me një kapacitet shkrirjeje prej 20 ton/ditë	
) g	Instalimet për prodhimin e produkteve qeramike përmes pjekjes, në veçanti, të tjegullave e të çative, tullave, tullave zjarrduruese, tjegullave, gresit ose porcelanit	Me një kapacitet prodhimi prej 75 ton/ditë ose një kapacitet pjekjeje prej 4 m ³ dhe me densitet vendosjeje për furrë prej 300 kg/m ³	
4	Industria kimike		
.			
) a	Instalimet kimike për prodhimin e një shkalle industriale të produkteve kimike organike bazë, të tillë si:	*	10 punonjës
	i) Hidrokarburet e thjeshtë (linearë ose ciklikë, të ngopur ose të pangopur, alifatik ose aromatik)		
	ii) Hidrokarburet me përmbajtje oksigjeni si, alkooli, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike, esterit, eterit, peroksidet, epoksi rezinat		
	iii) Hidrokarbonet sulfurike		
	iv) Hidrokarbonet nitrogjene, si aminet, amidet, përbërjet nitrike apo përbërjet e nitratit, nitrilet, cianatet, izocianatet		
	v) Hidrokarbonet me përmbajtje fosfori		
	vi) Hidrokarbonet halogjenike		10 punonjës

	vii) Përbërjet organometalike		
	viii) Materialet plastike bazë (polimeret, fibrat sintetike dhe fibrat me bazë celuloze)		
	ix) Gomat sintetike		
	x) Ngjyrimet dhe pigmentet		
	xi) Agjentët aktivë sipërfaqësorë dhe veshjet sipërfaqësore		
b)	Instalimet kimike për prodhimin e një shkalle industriale të produkteve kimike inorganike bazë si:	*	
	i) gazrat, si amoniak, klor ose klorur hidrogjeni. Oksidet e karbonit, përbërjet sulfurike, oksidet e nitrogenit, hidrogjen, dyoksid sulfuri, klor karboni.		
	ii) Acidet, të tilla si acidi kromik, acidi hidroflurik, acid fosforik, acid nitrik, acid hidroklorik, acid sulfurik, oleum, acidet sulfurike		
	iii) Bazat të tilla si hidroksid amoni, hidroksid potasiumi, hidroksid sodiumi		
	iv) kripërat, të tilla si klorid amoni, klorat potasiumi, karbonat potasiumi, karbonat sodiumi, nitrat argjendi		
	v) Jometalet, oksidet metalike ose përbërje të tjera inorganike, të tilla, si karbit kalciumi, silikon, karbit silikoni		
c)	Instalimet kimike për prodhimin e një shkalle industriale të fertilizuesve me bazë fosfori, nitrogeni ose potasiumi (fertilizues të thjeshtë ose të përbërë)	*	
d)	Instalimet kimike për prodhimin e një shkalle industriale të produkteve bimore bazë dhe të biocideve	*	
e)	Instalimet që përdorin një proces kimik ose biologjik për prodhimin e një niveli industrial të produkteve bazë farmaceutike	*	
f)	Instalimet për prodhimin në një shkallë industriale të eksplozivëve dhe produkteve piroteknike	*	10 punonjës
5 .	Menaxhimi i mbeturinave dhe i ujërave të ndotur		
a)	Instalimet për djegien, pirolizën, përpunimin, trajtimin kimik apo groposjen e mbetjeve të rrezikshme	Marrin 10 ton/ditë	

)	b	Instalimet për djegien e mbeturinave bashkiake	Me një kapacitet prej 3 ton/orë	10 punonjës
)	c	Instalimet për pastrimin e mbetjeve jo të rrezikshme	Me një kapacitet prej 50 ton/ditë	
)	d	Groposjet (duke përjashtuar groposjet e mbeturinave inerte)	Marrin 10 ton/ditë ose me një kapacitet total prej 25 000 ton	
)	e	Instalimet për pastrimin ose riciklimin e trupave të kafshëve apo mbeturinave shtazore	Me një kapacitet trajtimi prej 10 ton/ditë	
)	f	Fabrikat e trajtimit të ujërave të ndotur në nivel bashkie	Me një kapacitet korrespondues prej 100 000 banorësh	
)	g	Impiantet e pavarura të trajtimit të ujërave të ndotura industriale që i shërbejnë një ose disa aktiviteteve të këtij aneksi	Me një kapacitet prej 10 000 m ³ /ditë	
.	6	Prodhimi dhe përpunimi i letrës dhe i drurit		10 punonjës
)	a	Fabrikat industriale për prodhimin e brumit të letrës prej lëndës drusore ose materialeve të ngjashme fibroze	*	
)	b	Fabrikat industriale për prodhimin e letrës dhe dërrasës dhe produkteve të tjera parësore drusore (të tilla si tabela dërrase, dërrasa fibre dhe kompensatë)	Me një kapacitet prodhimi prej 20 ton/ditë	
)	c	Fabrikat industriale për ruajtjen e drurit dhe produkteve drusore me produkte kimike	Me një kapacitet prodhimi prej 50 m ³ /ditë	
.	7	Prodhimi intensiv blegtoral dhe kulturës ujore		
)	a	Instalimet për rritjen intensive të shpendëve dhe derrave	i) Me 40 000 vende për shpendët ii) Me 2 000 vende për prodhimin e derrave (mbi 30 kg) iii)Me 750 vende për dosa	10 punonjës
)	b	Kultura ujore intensive	1 000 ton peshq dhe molusqe në vit	10 punonjës
.	8	Produkte shtazore dhe bimore nga sektori i ushqimeve dhe pijeve		
)	a	Thertoret	Me një kapacitet të prodhimit të mishit të therur prej 50 ton/ditë	10 punonjës
)	b	Trajtimi dhe përpunimi për prodhimin e produkteve ushqimore		

	dhe pijeve nga: i) materialet e papërpunuara shtazore (përveç qumështit)	Me një kapacitet prodhimi produkti përfundimtar prej 75 ton/ditë	
	ii) Materialet e papërpunuara bimore	Me një kapacitet prodhimi produkti përfundimtar prej 300 ton/ditë (vlerë mesatare në bazë tremujore)	
) c	Trajtimi dhe përpunimi i qumështit	Me një kapacitet marrjeje prej 200 ton qumësht/ditë (vlerë mesatare mbi bazë vjetore)	
9	Veprimtari të tjera		
) a	Fabrika për paratrajtimin (veprime të tilla si larja, çngjyrosja) ose ngjyrosja e fibrave dhe tekstileve	Me një kapacitet trajtimi prej 10 ton/ditë	
) b	Fabrika për regjien e gëzofëve dhe lëkurëve	Me një kapacitet trajtimi prej 12 ton produkti përfundimtar/ditë	
) c	Instalimet për trajtimin e sipërfaqes së substancave, objekteve apo produkteve duke përdorur tretës organikë, veçanërisht për veshje, publikim, mbulesë, çlubrifikim, mbrojtjen nga uji, formatimin, lyerjen, pastrimin	Me një kapacitet konsumi prej 150 kg/orë ose 200 ton/vit	10 punonjës
) d	Instalimet për prodhimin e karbonit (qymyrguri i djegur fort) ose elektrografitë nëpërmjet djegies ose grafitizimit	*	
) e	Instalimet për ndërtimin e anijeve dhe lyerjen ose heqjen e bojës prej tyre	Me një kapacitet për anije 100 m të gjata	

Shënime shpjeguese

Kolona 1 përmban pragjet e kapacitetit të treguar në nenin 7 paragrafi 1 (a).

Një asterisk (*) tregon që nuk ka prag kapaciteti të aplikueshëm (të gjitha shërbimet janë subjekt i raportimit).

Kolona 2 përmban pragun e punësimit të treguar në nenin 7 paragrafi 1(b).

“10 punonjës” nënkupton ekuivalentin e 10 punonjësve të punësuar me kohë të plotë.

SHTOJCA II
NDOTËSIT

r.	Nr .CAS	Ndotësi	Pragu i shkarkimeve (kolona 1)			Kufiri për transferimin jashtë impiantit ndotësve (Kolona 2) kg/vit	Pragu i prodhimit, përpunimit apo përdorimit (kolona 3) kg/vit
			ë ajër (kolona 1a) kg/vit	ë ujë (Kolona 1b) kg/vit	ë tokë (Kolona 1c) kg/vit		
	74 -82-8	Metan (CH ₄)	100 000	-	-	-	*
	63 0-08-0	Monoksid karboni (CO)	500 000	-	-	-	*
	12 4-38-9	Dyoksid karboni (CO ₂)	100 milion	-	-	-	*
		Hidro-fluorokarbonet (HFCs)	100	-	-	-	*
	10 024-97-2	Oksid azoti (N ₂)	10 000	-	-	-	*
	76 64-41-7	Amoniak (NH ₃)	0 000	-	-	-	10 000
	-	Përbërjet organike të avullueshme pa metan (NMVOC)	100 000	-	-	-	*
		Oksidet e nitrogjenit (NO _x /NO ₂)	100 000	-	-	-	*
		Perfluorokarbonet (PFCs)	100	-	-	-	*
0	25 51-62-4	Heksafluoridi sulfurit (SF ₆)	50	-	-	-	*
1		Oksid sulfuri (SO _x /SO ₂)	50 000	-	-	-	*
2		Nitrogjen total	-	50 000	50 000	10 000	10 000
3		Fosfor Total	-	5 000	5 000	10 000	10 000
4		Hidroklorofluoro karbonet (HCFC _s)	1	-	-	100	10 000
5		Klorofluorokarbonet (CFC _s)	1	-	-	100	10 000
6		Halons	1	-	-	100	10 000
7	74 40-38-2	Arsenik dhe përbërjet (si As)	20	5	5	50	50
8	74 40-43-9	Kadmium dhe përbërjet (si Cd)	10	5	5	5	5
9	74 40-47-3	Kromi dhe përbërjet (si Cr)	100	50	50	200	10 000
0	74 40-50-8	Bakër dhe përbërjet (si Cu)	100	50	50	500	10 000
1	74 39-97-6	Mërkuri dhe përbërjet (si Hg)	10	1	1	5	5
2	74 40-02-0	Nikel dhe përbërjet (si Ni)	50	20	20	500	10 000

3	74 39-92-1	Plumbi dhe përbërjet (si Pb)	00	20	20	50	50
4	74 40-66-6	Zink dhe përbërjet (si Zn)	00	10	10	1	10
5	15 972-60-8	Alaklor		1	1	5	10
6	30 9-00-2	Aldrin		1	1	1	1
7	19 12-24-9	Atrazine		1	1	5	10
8	57 -74-9	Klordan		1	1	1	1
9	14 3-50-0	Klordekon		1	1	1	1
0	47 0-90-6	Klorfenvin		1	1	5	10
1	85 535-84-8	Kloro-alkanet, C ₁₀ -C ₁₃		1	1	10	10
2	29 21-88-2	Klorpirif		1	1	5	10
3	50 -29-3	DDT		1	1	1	1
4	10 7-06-2	1,2-diklorethan (EDC)	000	10	10	100	10
5	75 -09-2	Diklorometan (DCM)	000	10	10	100	10
6	60 -57-1	Dieldrin		1	1	1	1
7	33 0-54-1	Diuron		1	1	5	10
8	11 5-29-7	Endosulfan		1	1	5	10
9	72 -20-8	Endrin		1	1	1	1
0		Përbërjet organike halogjene (si AOX)		000	1	000	10
1	76 -44-8	Heptaklor		1	1	1	1
2	11 8-74-1	Heksaklorobenzen (HCB)	0	1	1	1	5
3	87 -68-3	Heksaklorobutadien (HCBd)		1	1	5	10
4	60 8-73-1	1,2,3,4,5,6- heksaklorocikloheksan (HCH)	0	1	1	1	10
5	58 -89-9	Lindan		1	1	1	1
6	23 85-85-5	Mireks		1	1	1	1
7		PCDD+PCDF (dioksina+furane) (si Teq)	.001	0.001	0.001	0.001	0.001
	60	Pentaklorobenzen		1	1	5	50

8	8-93-5						
9	87 -86-5	Pentaklorofenol (PCP)	0	1	1	5	10 000
0	13 36-36-3	Bifenilet poliklorinuara (PCBs)	0 .1	0 1	0 1	1	50
1	12 2-34-9	Simazin		1	1	5	10 000
2	12 7-18-4	Tetrakloroetilen (PER)	000	-	-	1	10 000
3	56 -23-5	Tetraklorometan (TCM)	00	-	-	1	10 000
4	12 002-48-1	Triklorobenzen (TCBs)	0	-	-	1	10 000
5	71 -55-6	1,1,1-trikloroetan	00	-	-	1	10 000
6	79 -34-5	1,1,2,2- tetrakloroetane	0	-	-	1	10 000
7	79 -01-6	Trikloroetilen	000	-	-	1	10 000
8	67 -66-3	Triklorometan	00	-	-	1	10 000
9	80 01-35-2	Toksafen		1	1	1	1
0	75 -01-4	Vinil kloridi	000	10	10	100	10 000
1	12 0-12-7	Antracen	0	1	1	50	50
2	71 -43-2	Benzen	000	20 (si BTEX) ^{a/}	20 (si BTEX) ^{a/}	200 (si BTEX) ^{a/}	10 000
3		Difenil eteret e bromuara (PBDE)		1	1	5	10 000
4		Nonifenol etoksilatet (NP/NPEs) dhe substancat e ngjashme		1	1	5	10 000
5	10 0-41-4	Etil benzen		20 (si BTEX) ^{a/}	20 (si BTEX) ^{a/}	200 (si BTEX) ^{a/}	10 000
6	75 -21-8	Oksid etilen	000	10	10	100	10 000
7	34 123-59-6	Izoproturon		1	1	5	10 000
8	91 -20-3	Nafthalin	00	10	10	100	10 000
9		Përbërjet organotin (si total Sn)		50	50	50	10 000
0	11 7-81-7	Dy-(2-etil eksil)ftalate (DEHP)	0	1	1	100	10 000
1	10 8-95-2	Fenol 9(si total C)		20	20	200	10 000
2		Hidrokarbonet aromatike policiklike (PAHs) ^b	0	5	5	50	50
	10	Toluen		20	20	200	10

3	8-88-3			0 (si BTEX) ^{a/}	0 (si BTEX) ^{a/}	0 (si BTEX) ^{a/}	000
4		Tributitin dhe përbërjet		1	1	5	10 000
5		Trifeniltin dhe përbërjet		1	1	5	10 000
6		Karbon organik total (TOC) (si total C ose COD/3)		50 000	-	-	**
7	15 82-09-8	Trifluralin		1	1	5	10 000
8	13 30-20-7	Ksilen		20 (si BTEX) ^{a/}	20 (si BTEX) ^{a/}	200 (si BTEX) ^{a/}	10 000
9		Kloridet (si total Cl)		2 milion	2 milion	2 milion	10 000 ^c
0		Klori dhe përbëhet inorganike (si HCl)	0 000	-	-	-	10 000
1	13 32-21-4	Asbest		1	1	10	10 000
2		Cianidet (si total CN)		50	50	500	10 000
3		Fluoridet (si total F)		2 000	2 000	10 000	10 000 ^c
4		Fluori dhe përbërjet inorganike (si HF)	000	-	-	-	10 000
5	74 -90-8	Hidrogjen cianid (HCN)	00	-	-	-	10 000
6		Lënda e grimcuar pezull (PM10)	0 000	-	-	-	*

Shënime shpjeguese

Numri CAS i ndotësve nënkupton identifikuesin e saktë në shërbimin abstrakt të kimikateve (Chemical Abstracts Service).

Kolona 1 përmban pragjet e përmendura në nenin 7 paragrafi 1(a)(i) dhe (iv). Nëse kalohet pragu në një nënkolonë (ajër, ujë, tokë), kërkohet raportimi i shkarkimeve ose, për ndotësit në ujërat e ndotura të destinuara për trajtimin e këtyre të fundit, transferimeve në hapësirat mjedisore të përmendura në atë nënkolonë, lidhur me shërbimin në fjalë për ato palë që kanë zgjedhur një sistem raportimi në vijim të nenit 7 paragrafi 1(a).

Kolona 2 përmban pragjet e treguara në nenin 7 paragrafi 1(a)(ii). Nëse pragu për një ndotës të dhënë në këtë kolonë është kaluar, kërkohet raportimi i transferimeve jashtë impiantit të këtij ndotësi lidhur me shërbimin në fjalë, për ato palë që kanë zgjedhur një sistem raportimi në vijim të nenit 7 paragrafi 1 (a)(ii).

Kolona 3 përmban pragjet e treguara në nenin 7 paragrafi 1(b). Nëse pragu për një ndotës të dhënë në këtë kolonë është kapërcyer, kërkohet raportimi i shkarkimeve dhe transferimeve jashtë impiantit të këtij ndotësi lidhur me shërbimin në fjalë, për ato palë që kanë zgjedhur një sistem raportimi në vijim të nenit 7 paragrafi 1 (b).

Një shenjë minus (-) tregon që parametri në fjalë nuk plotëson një kërkesë raportimi.

Një asterisk (*) tregon se, për këtë ndotës, pragu i shkarkimit në kolonën (i)(a) duhet përdorur para pragut të prodhimit, përpunimit apo përdorimit.

Një asterisk i dyfishtë (**) tregon se, për këtë ndotës, pragu i shkarkimit në kolonën (1)(b) duhet përdorur para pragut të prodhimit, përpunimit apo përdorimit.

Shënime.

a) Ndotësit e veçantë duhen përdorur nëse është kapërcyer pragu për BTEX (parametri shumë i benzenit, toluenit, etil benzenit, ksilenit).

b) Hidrokarbonet aromatike policiklike (PAHs) duhen matur si benzo(a)pirene (50-32-8), benzo(b)fluorantene (205-92-2), benzo(k)fluorantene (207-08-9), indeno (1,2,3-cd) pyrene (193-39-5) (të derivuara nga Protokolli për ndotësit organikë të qëndrueshëm të Konventës së Ndotjes së Ajrit në distanca të mëdha ndërkufitare).

c) Si përbërje inorganike.

SHTOJCA III

PJESA A

Operacionet asgjësuese ('D')

- Depozitimi në brendësi ose në sipërfaqe të tokës (p.sh. groposja).
- Trajtimi i tokës (p.sh. biodergradimi i hedhjeve likuide ose ndotëse në tokë).
- Injektimi i thellë (p.sh. injektimi i hedhjeve të rrjedhshme në puse, gropa të krijuara nga depozitime natyrale).
- Zotërimi i sipërfaqeve (p.sh. vendosja e hedhurinave likuide ose të ndotura në gropa të thella, liqene të vogla ose laguna).
- Landfille (venddepozitime)inxhinierike speciale (p.sh. vendosja në qeliza të veçanta të renditura të izoluara nga njëra-tjetra dhe nga mjedisi).
- Shkarkimi në një pjesë ujore përveç deteve/oqeanëve.
- Shkarkimi në dete/oqeanë përfshirë futjen në shtratin detar.
- Trajtimi fiziko-kimik i paspecifikuar në këtë shtojcë, i cili rezulton në përbërje ose përzierje përfundimtare, të cilat shkarkohen nëpërmjet mjeteve të ndonjë prej operacioneve të specifikuara në këtë pjesë.
- Trajtimi fiziko-kimik i paspecifikuar në këtë shtojcë, i cili rezulton në përbërje ose përzierje përfundimtare, që shkarkohen nëpërmjet mjeteve të ndonjë operacioni të specifikuar në këtë pjesë (p.sh. avullimi, tharja, kalcifikimi, neutralizimi, precipitimi).

- Djegia në tokë.
- Djegia në det.
- Magazinimi i përkohshëm p.sh. vendosje e konteinerëve në minierë.
- Përzierja përpara dorëzimit në ndonjë nga operacionet e specifikuara në këtë pjesë.
- Ripaketimi para dorëzimit në ndonjë nga operacionet e specifikuara në këtë pjesë.
- Magazinimi gjatë ndonjë nga operacionet e specifikuara në këtë pjesë.

PJESA B

OPERACIONET RIKUPERUESE ('R')

- Përdorimi si naftë (dhe jo në djegie të drejtpërdrejtë) ose mjete të tjera për gjenerimin e energjisë.
- Riciklimi/rigjenerimi i substancave organike, që nuk përdoren si tretës.
- Riciklimi/rigjenerimi i metaleve dhe përbërjeve metalore.
- Riciklimi/rigjenerimi i materialeve të tjera inorganike.
- Rigjenerimi i acideve ose bazave.
- Përpunimi i përbërësve të përdorur për uljen e ndotjes.
- Përpunimi i përbërësve nga katalizatorët.
- Rirafinimi i vajit të përdorur ose të tjera ripërdorime të vajit të përdorur më parë.
- Trajtimi i tokës në favor të bujqësisë ose përmirësimit ekologjik
- Përdorimi i materialeve të mbetura të marra nga ndonjë prej operacioneve të përpunimit të specifikuar më lart në këtë pjesë.
- Shkëmbimi i mbeturinave për t'u dorëzuar në ndonjë prej operacioneve të përpunimit të specifikuar më lart në këtë pjesë.
- Akumulimi i materialeve të synuar për ndonjë nga operacionet e specifikuara në këtë pjesë.

SHTOJCA IV

ARBITRAZHI

1. Në kuadrin e një diskutimi të bërë për arbitrazhin në vijim të nenit 23 paragrafi 2 të këtij Protokolli, një palë apo palët do të njoftojë palën apo palët e tjera në diskutim përmes mjeteve diplomatike, sikurse dhe sekretariatit, për çështjen e arbitrazhit dhe të tregojnë, në veçanti, nenet e këtij Protokolli, interpretimi dhe përdorimi i të cilëve i takojnë kësaj çështjeje. Sekretariati do t'ua kalojë informacionin e marrë të gjitha palëve të këtij Protokolli.

2. Gjykata arbitrale do të përbëhet nga 3 anëtarë. Pala apo palët pretenduese dhe pala apo palët e tjera në diskutim do të caktojnë një gjykatës dhe të dy gjykatësit e zgjedhur në këtë mënyrë do të zgjedhin përmes një

marrëveshjeje të përbashkët gjykatësin e tretë, i cili do të jetë presidenti i gjykatës arbitrale. Ky i fundit nuk duhet të jetë bashkëkombës i ndonjë prej palëve në diskutim, nuk duhet të jetë rezident në territorin e ndonjë prej këtyre palëve, nuk duhet të jetë i punësuar prej ndonjëres prej tyre, si dhe nuk duhet të jetë marrë me këtë çështje në ndonjë funksion tjetër.

3. Nëse presidenti i gjykatës arbitrale nuk është përcaktuar brenda dy muajsh pas zgjedhjes së gjykatësit të dytë, Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën do të caktojë presidentin, me kërkesën e çdo pale në diskutim, brenda një periudhe të mëpasshme dy mujore.

4. Nëse një nga palët në diskutim nuk përcakton një gjyqtar brenda dy muajve të lajmërimit të përmendur në paragrafin 1, Pala tjetër mund të informojë në këtë mënyrë Sekretarin Ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Europën, i cili do të zgjedhë presidentin e gjykatës arbitrale brenda një periudhe të mëpasshme dymujore. Pas zgjedhjes, presidenti i gjykatës arbitrale do t'i kërkojë palës që nuk ka caktuar një gjyqtar, ta bëjë këtë gjë brenda dy muajve. Nëse kjo palë nuk arrin ta bëjë këtë brenda kësaj periudhe, atëherë Presidenti do të informojë Sekretarin Ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Europën, i cili do e bëjë këtë emërim në dy muajt e mëpasshëm.

5. Gjykata arbitrale duhet t'i marrë vendimet e saj në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe dispozitat e këtij Protokolli.

6. Çdo gjykatë arbitrale e krijuar sipas dispozitave të vendosura në këtë shtojcë, do të përgatisë rregullat e saj personale të procedurës.

7. Vendimet e gjykatës arbitrale, si në procedurë dhe në temë, do të merren me shumicën e votave të anëtarëve të saj.

8. Gjykata mund të marrë të gjitha masat e duhura për verifikimin e fakteve.

9. Palët në diskutim duhet të lehtësojnë punën e gjykatës arbitrale, dhe në veçanti, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion të tyre, duhet:

a) T'i sigurojnë asaj gjithë dokumentet, lehtësirat dhe informacionin e nevojshëm;

b) Ta mundësojë atë, kur është e nevojshme, të thërrasë dëshmitarë ose ekspertë dhe të marrë evidencat e tyre.

10. Palët dhe gjyqtarët duhet të ruajnë fshehtësinë e çdo informacioni që ata marrin në mirëbesim gjatë ecurisë së gjyqit arbitrar.

11. Gjykata arbitrale mund, me kërkesën e njëres prej palëve, të rekomandojë masa të brendshme mbrojtjeje.

12. Nëse njëra nga palët në diskutim nuk paraqitet para gjykatës arbitrale apo dështon në mbrojtjen e çështjes së saj, Pala tjetër mund t'i kërkojë gjykatës të vazhdojë punimet dhe të japë vendimin përfundimtar të saj. Mungesa e një pale ose dështimi i saj në mbrojtjen e çështjes nuk do të përbëjë një pengesë për punimet. Para marrjes së vendimit përfundimtar, gjykata arbitrale duhet të mbetet e kënaqur në vetvete për gjetjen e drejtë të akuzës, bazuar në fakt dhe ligj.

13. Gjykata arbitrale mund të dëgjojë dhe përcaktojë kundërakuzat që vijnë drejtpërdrejt prej temës së diskutimit.

14. Derisa gjykata arbitrale vendos të kundërtën, si pasojë e rrethanave të veçanta të çështjes, shpenzimet e gjyqit, përfshirë pagesën e anëtarëve të saj, do të mbahen nga palët në diskutim në pjesë të barabarta. Gjyqi duhet të mbajë një dokument me të gjitha shpenzimet e tij dhe duhet t'u dorëzojë një gjendje përfundimtare të tij palëve.

15. Çdo palë e këtij Protokolli, që ka interes të një natyre ligjore në çështjen e diskutimit dhe që mund të preket nga një vendim i çështjes, mund të ndërhyjë në punimet e seancës me pëlqimin e gjyqit.

16. Gjykata arbitrale duhet të japë verdiktin e saj brenda 5 muajve pas datës së krijimit, derisa ajo e sheh të nevojshme shtrirjen e afatit përfundimtar për një periudhë, që nuk i kalon 5 muaj.

17. Verdikti i gjykatës arbitrale duhet të shoqërohet me një deklaram të arsyeve. Ai duhet të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për çdo palë pjesëmarrëse në diskutim. Verdikti do t'u transmetohet palëve në diskutim dhe sekretariatit. Sekretariati do t'ua transmetojë informacionin e marrë të gjithë palëve të këtij Protokolli.

18. Çdo diskutim që mund të ndodhë midis palëve, lidhur me interpretimin ose zbatimin e vendimit, mund t'i paraqitet nga çdo Palë gjykatës arbitrale, që mori vendimin, ose, nëse kjo e fundit nuk mund të bëjë kontrollin e këtij fakti, një gjykate tjetër të krijuar për këtë qëllim, në të njëjtën mënyrë si e para.

L I G J

Nr.9549, datë 1.6.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GRANTIT TË OBJEKTIVIT STRATEGJIK,
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË**

AMERIKËS, PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN, NË KUADËR TË PROGRAMIT FILLESTAR TË VLERËSIMIT TË SFIDËS SË MIJËVJEÇARIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e grantit e objektivit strategjik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4929, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**PROGRAMI FILLESTAR I LLOGARISË SË SFIDËS SË MIJËVJEÇARIT
MARRËVESHJE GRANTI E OBJEKTIVIT STRATEGJIK**

Datë 3 prill 2006

Ndërmjet

Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (“USAID”) dhe

Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (këtu më poshtë referuar si “Marrësi i Grantit”)

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Granti të objektivit strategjik (“Marrëveshja”) është njohja nga palët e emërtuara më sipër (“Palët”) mbi objektivin strategjik të përshkruar më poshtë.

Neni 2

Objektivi strategjik dhe rezultatet

Seksioni 2.1 Objektivi strategjik.

Objektivi strategjik (“Objektivi Strategjik” ose “Objektivi”) është ulja e korrupsionit, forcimi i shtetit ligjor dhe përmirësimi i lirisë ekonomike në Shqipërisë.

Seksioni 2.1 mund të mos ndryshohet, përveçse me anë të amendimit formal me shkrim të kësaj Marrëveshjeje nga përfaqësuesit e autorizuar, siç përcaktohet në seksionin 7.3.

Seksioni 2.2 Rezultatet

Me qëllim arritjen e objektivit, Palët bien dakord të punojnë së bashku për të arritur rezultatet e mëposhtme (secili referuar si “Rezultati” dhe së bashku si “Rezultatet”):

- a) ulja e korrupsionit në politikën tatimore dhe administratë;
- b) arritja e transparencës dhe ulja e korrupsionit në prokurimin publik;
- c) lufta kundër korrupsionit në hyrjen dhe regjistrimin e bizneseve dhe krijimi i një qendre kombëtare biznesi

Seksioni 2.2 mund të mos ndryshojë përveç amendamentit formal me shkrim ndaj kësaj Marrëveshjeje nga ana e përfaqësuesve të autorizuar.

Seksioni 2.3 Shtojca 1, Përshkrim i zgjeruar. Shtojca 1 që ndodhet bashkëngjitur është pjesë e kësaj Marrëveshjeje dhe përforcon objektivin dhe rezultatet e mësipërme. Brenda kufijve të përcaktimeve të mësipërme të objektivit në seksionin 2.1 dhe rezultateve në seksionin 2.2, shtojca 1 mund të ndryshohet vetëm me anë të një marrëveshjeje me shkrim të përfaqësuesve të autorizuar, pa amendimin formal të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Kontributet e Palëve

Seksioni 3.1 Kontributi i USAID-it Granti

Për të ndihmuar arritjen e objektivit të parashtruar në këtë marrëveshje, USAID-i, sipas kushteve të paraqitura në këtë Marrëveshje dhe sipas Aktit të Ndihmës së Huaj të vitit 1961, siç është amenduar dhe seksionit 616 të Aktit të Sfidës së Mijëvjeçarit të vitit 2003, i jep Marrësit të Grantit një sasi që nuk tejkalon sasinë e trembëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë dollarëve amerikanë ("US") (13 850 000 \$) ("Granti")

Seksioni 3.2 Kontributi i Marrësit të Grantit.

Marrësi i Grantit do të sigurojë ose do të nxisë sigurimin e të gjitha fondeve, përveç atyre të siguruara nga USAID-i dhe ndonjë donator tjetër i identifikuar në shtojcën 1 dhe të gjitha burimet e tjera të kërkuara për të përfunduar të gjitha aktivitetet e nevojshme për arritjen e rezultateve në datën e përfundimit ose para saj. Mbështetja ndaj Marrësit të Grantit do të përfshijë, por nuk do të jetë e kufizuar ndaj të gjitha kostove organizative të shoqëruara me arritjen e rezultateve.

Neni 4
Data e përfundimit

a) Data e përfundimit, 15 korrik 2008 ose ndonjë datë tjetër sipas miratimit me shkrim të Palëve, është data në të cilën Palët vlerësojnë se do të përfundojnë të gjitha aktivitetet e nevojshme për arritjen e objektivit dhe rezultateve.

b) Përveç rasteve kur USAID mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, USAID nuk do të lëshojë ose miratojë dokumentacion që do të autorizonte disbursimin e grantit për shërbime të kryera ose mallra të dhëna pas datës së përfundimit.

c) Kërkesat për disbursim, të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës të nevojshëm, të parashikuara në dokumentet e zbatimit, duhet të merren nga USAID jo më vonë se nëntë (9) muaj pas datës së përfundimit ose në një periudhë tjetër, sipas miratimit me shkrim nga ana e USAID-it. Pas kësaj periudhe, USAID, në çdo kohë, mund të njoftojë me shkrim Marrësin e Grantit dhe të ulë sasinë e grantit për të gjithë ose një pjesë të tij, për të cilat nuk janë marrë kërkesat për disbursim para mbarimit të asaj periudhe, të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës të nevojshëm të parashikuar në dokumentet e zbatimit.

Neni 5
Kushtet që i paraprijnë disbursimit

Seksioni 5.1 Disbursimi i parë

Para disbursimit të parë sipas grantit ose me lëshimin nga ana e USAID-it të dokumentacionit sipas të cilit do të bëhet ky disbursim, Marrësi i Grantit, përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do t'i japim USAID-it në formë dhe përmbajtje të pranueshme për USAID-in:

a) Një opinion ligjor të Ministrisë së Drejtësisë që kjo Marrëveshje është autorizuar në mënyrën e duhur ose e ratifikuar dhe ekzekutuar në emër të Marrësit të Grantit dhe që përbën një detyrim të vlefshëm dhe të ligjshëm të Marrësit të Grantit, në përputhje me të gjitha kushtet e saj; si dhe

b) Një deklaratë në emër të personit që është në detyrën ose që vepron si Marrësi i Grantit, specifikuar në seksionin 7.3 dhe të ndonjë përfaqësuesi shtesë të Palëve, së bashku me një model nënshkrimi të secilit person, specifikuar në këtë deklaratë.

Seksioni 5.2 Njoftimi

USAID-i do të njoftojë menjëherë Marrësin e Grantit në lidhje me kohën kur USAID-i ka konstatuar që është plotësuar një kusht pararendës.

Seksioni 5.3 Datat përfundimtare për kushtet pararendëse

Data përfundimtare për plotësimin e kushteve të specifikuara në seksionin 5.1 është gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë datë e mëvonshme që do të vendoset sipas miratimit me shkrim të USAID-it. Nëse kushtet pararendëse në seksionin 5.1 nuk janë plotësuar deri në datën përfundimtare të mësipërme, USAID-i mund ta mbyllë Marrëveshjen me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Marrësit të Grantit.

Neni 6

Marrëveshje të posaçme

Marrësi i Grantit angazhohet që të punësojë staf shtesë profesional, të sigurojë zyra dhe të marrë masat e nevojshme rregullatore dhe ligjore për zbatimin e suksesshëm të të gjitha aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7 Të ndryshme

Seksioni 7.1 Disbursimi financiar.

Palët bien dakord që aktivitetet e shqyrtuara sipas kësaj Marrëveshjeje do të ndërmerren në përputhje me rregullat, rregulloret, politikat dhe procedurat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe që USAID-i do t'ia disbursojë të gjitha fondet sipas kësaj Marrëveshjeje, Partnerëve Zbatues (siç përcaktohet në shtojcën 1) në përputhje me këto rregulla, rregullore, politika dhe procedura.

Seksioni 7.2 Komunikimi

Çdo njoftim, kërkesë, dokument ose komunikim tjetër që secila Palë i dorëzon Palës tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë (a) me shkrim ose me anë të telegramit, telefaksit ose telegrafit dhe (b) do të konsiderohet e dhënë ose e dërguar kur i dërgohet asaj Palë në adresën e mëposhtme:

Drejtuar USAID-it:

Adresa Postare:
Mission Director (Drejtuesi i Misionit)
United States Agency for International
Development
Embassy of the United States of Albania
Rr.Elbasanit 103
Tirana, Albania
Telefaks: +355 4 366 394

Drejtuar Marrësit të Grantit:
Adresa Postare:
Ministër Ridvan Bode
Ministry of Finance
Blvd."Dëshmorët e Kombit"
Nr.4 Tirana, Albania

Të gjitha këto komunikime do të jenë në gjuhën angleze, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe me shkrim. Marrësit e tjerë mund të zëvendësohen për më sipër pas dorëzimit të një njoftimi paraprak Palës tjetër.

Seksioni 7.3 Përfaqësuesit

Për të gjitha qëllimet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje, Marrësi i Grantit do të përfaqësohet nga individë që ka pozicionin individual ose vepron si Ministri i Financave dhe USAID-i do të përfaqësohet nga individë që ka pozicionin individual ose vepron si Drejtues i Misionit, USAID/Shqipëri (secili referohet si "Përfaqësues i Autorizuar" dhe së bashku si "Përfaqësuesit e Autorizuar"). Secili prej Përfaqësuesve të Autorizuar, me anë të një njoftimi me shkrim, mund të caktojë përfaqësues shtesë ("Përfaqësuesit Shtesë") për të gjitha qëllimet përveç nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, nënshkrimit të amendimeve formale ndaj Marrëveshjes ose ushtrimit të detyrës sipas seksionit 2.3 për të ndryshuar shtojcën 1. Emrat e Përfaqësuesit të Autorizuar dhe Përfaqësuesve Shtesë të Marrësit të Grantit, me modelin e nënshkrimit, do t'i jepen USAID-it dhe ky i fundit mund të pranojë si të autorizuar çdo instrument të nënshkruar nga këta përfaqësues në bërjen e kësaj Marrëveshjeje, deri në marrjen e njoftimit me shkrim të revokimit të autoritetit të tyre.

Seksioni 7.4

Shtojca e dispozitave standarde

"Një shtojcë e dispozitave standarde" (shtojca 2) i bashkëngjitet dhe bëhet pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.5 Amendimet

Për sa kohë që nuk specifikohet ndryshe, Palët mund ta amendojnë këtë Marrëveshje vetëm me anë të një amendimi me shkrim të nënshkruar nga Përfaqësuesit e Autorizuar.

Seksioni 7.6 Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

"Qeveria e Republikës së Shqipërisë" do të thotë dhe është e barabartë me termin kushtetues të Shqipërisë "Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë".

Në dëshmi të kësaj, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Marrësi i Grantit, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Nga.....
Emri: Harry Birnholz
Pozicioni: Drejtuesi i Misionit

Qeveria e Republikës së Shqipërisë
Nga:.....
Emri: Ridvan Bode
Pozicioni: Ministri i Financave

Dëshmuar nga:
Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
Nga:
Emri: John J.Danilovich
Titulli: Drejtori Ekzekutiv

SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I ZGJERUAR

I.Hyrje

Shtojca 1 përshkruan aktivitetet që duhet të ndërmerren dhe rezultatet që duhen arritur me fondet e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Asgjë në shtojcën 1 nuk do të interpretohet si amendim i ndonjë prej përcaktimeve ose kushteve të Marrëveshjes.

II.Historik

Më 30 shtator 2004 Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (“MCC”) zgjodhi Shqipërinë si kandidate për të marrë asistencën e programit fillestar për të asistuar Shqipërinë, u bë kandidate për asistencën e Marrëveshjes së Llogarisë të Sfidës së Mijëvjeçarit (“MCA”).

Mes treguesve të përzgjedhjes së MCC-së, Shqipëria zhvilloi poshtë mesatares në kontrollin e korrupsionit dhe shtetin ligjor dhe pati një paraqitje të dobët në katër prej gjashtë treguesve të Lirisë Ekonomike (Politika Fiskale, Politika Tregtare, Ditët për Hapjen e Biznesit dhe Vlerësimi Financiar i Kredisë).

Më 19 dhjetor 2005, Qeveria e Republikës së Shqipërisë (“Qeveria”) dorëzoi një propozim që parashtrroi strategjinë e tij për luftimin e korrupsionit, forcimin e shtetit ligjor, investimi në njerëz dhe përmirësimi i lirisë ekonomike. Më 8 shkurt 2006, Bordi i Drejtuesve të MCC miratoi një program fillestar të MCC për Shqipërinë, kryesisht si të përshkruar në këtë Marrëveshjeje (“Programi”). Programi përfshin tre komponentë: (1) ulja e korrupsionit në politikën dhe administratën tatimore (“Reforma e administratës tatimore”), (2) arritja e transparencës dhe ulja e korrupsionit në prokurimin publik (“Reforma e prokurimit publik”), (3) lufta kundër korrupsionit në hyrjen dhe regjistrimin e biznesit dhe krijimi i një qendre kombëtare biznesi (“Reforma e regjistrimit të biznesit”).

III. Objektivi strategjik, rezultatet që duhen arritur

Objektivi strategjik i kësaj Marrëveshjeje është ulja e korrupsionit, forcimi i shtetit ligjor dhe përmirësimi i lirisë ekonomike në Shqipëri. Për të arritur këtë objektivi, duhen arritur rezultatet e mëposhtme për komponentët përkatës të programit:

A. Reforma e administratës tatimore

1. Përmirësimi i mbledhjes së taksave dhe komunikimit me entet qeveritare me anë të përmirësimit të teknologjisë së informacionit të zyrës tatimore;
2. Kufizimi i ndërveprimit personal të punonjësve tatimorë me taksapaguesit dhe shkalla e kujdesit të tyre në vlerësimin dhe mbledhjen e taksave;
3. Zgjerimi i bazës tatimore, duke përfshirë një përqindje më të lartë të ekonomisë;
4. Zhvillimi i një ekspertize teknike dhe përmirësimi i procedurave me anë të trajnimeve dhe manualeve për mbledhësit e taksave, kontrollorët e brendshëm financiarë dhe gjyqësorin;
5. Krijimi i një mjedisi më të mirë ligjor për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
6. Zhvillimi i një fushate ambicioze edukimi publik, në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e taksapaguesve.

B. Reforma e prokurimit publik

1. Reforma e procesit të prokurimit publik për të përmirësuar transparencën dhe lehtësuar inspektimin publik të procedurave të prokurimit, duke përdorur teknologjinë e informacionit;
2. Zhvillimi i mekanizmave të përgjegjësisë institucionale për të zbuluar, parandaluar dhe dënuar praktikën korruptive, të shoqëruara me prokurimin e punimeve, mallrave dhe shërbimeve;
3. Përpunueshmëria e plotë e sistemit ekzistues të prokurimit publik me ligjin e prokurimit publik të vitit 1995;

4. Forcimi i kapaciteteve teknike të Agjencisë së Prokurimit Publik, për të ushtruar monitorim të kujdesshëm ndaj enteve të prokurimit për të siguruar një transparencë më të lartë nën sistemin e prokurimit publik;

5. Sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme, profesionale dhe të qëndrueshme për punonjësit e prokurimit në të gjitha entet prokuruese për të rritur nivelin e aftësive dhe forcuar angazhimin ndaj procesit të zhvillimit të prokurimit.

C. Reforma e regjistrimit të biznesit

1. Ristrukturimi i procesit të vështirë dhe fragmentar të regjistrimit të bizneseve;
2. Ulja në mënyrë të dukshme e volumit të ekonomisë informale;
3. Ulja e lirisë së veprimit administrativ në regjistrimin e bizneseve;
4. Lufta kundër korrupsionit në regjistrimin e bizneseve dhe sistemin gjyqësor;
5. Përmirësimi i pozicionit fiskal të Shqipërisë nëpërmjet mbledhjes së taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.

IV. Rolet dhe përgjegjësitë

A. Qeveria

Në lidhje me kryerjen e aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshjeje, Qeveria do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar arritjen e rezultateve dhe objektivave, siç janë shqyrtuar në këtë Marrëveshje.

Në vijim, por pa kufizuar ato që u cituan më sipër, Qeveria do të: a) paguajë për rrogat vjetore dhe kostot organizative të stafit të Qeverisë, të caktuar për monitorimin e programit; b) sigurojë zyrat për stafin e partnerëve zbatues të përzgjedhur (siç përcaktohet më poshtë); c) sigurojë monitorimin e programit; dhe d) sigurojë mbështetjen e buxhetit dhe përsëritjen e mësimave të nxjerra për të mbështetur aktivitetet e programit pas datës së përfundimit dhe për t'u zgjeruar në fushat e tjera.

B. USAID-i

USAID-i do të punojë ngushtësisht me Qeverinë (specifikisht Ministria e Financave) për të asistuar Qeverinë në zbatimin e suksesshëm të programit dhe për arritjen e rezultateve dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje.

USAID-i do të hyjë në një ose më shumë marrëveshje me një ose më shumë partnerë zbatues palë të treta (secili referuar si "Partner Zbatues") për zbatimin e programit. Këto marrëveshje mund të përfshijnë grante, marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata. Partnerët Zbatues mund të jenë lokalë, Shtetet e Bashkuara, ndërkombëtarë ose shumëkombësh, qeveritarë ose joqeveritarë, organizata ose individë. USAID-i do të përzgjedhë Partnerët Zbatues në përputhje me rregulloret dhe politikat e USAID-it dhe në konsultim me përfaqësuesit e Qeverisë dhe MCC.

USAID-i do të monitorojë performancën sipas këtyre marrëveshjeve dhe do të monitorojë performancën e Partnerëve Zbatues dhe ecurinë drejt arritjes së rezultateve.

USAID-i do t'i japë Drejtorisë së Thesarit të Ministrisë së Financave informacion mbi disbursimet që lidhen me këtë Marrëveshje në një format dhe përmbajtje të rënë dakord ndërmjet të dyja Palëve.

C. Partnerët Zbatues

USAID-i do të përzgjedhë Partnerët Zbatues, duke u konsultuar me Marrësin e Grantit dhe do të sigurojë që Partnerët Zbatues të kryejnë zbatimin e programit në përputhje me këtë Marrëveshje dhe t'i raportojë USAID-it në mënyrë të drejtpërdrejtë. Çdo marrëveshje ndërmjet USAID-it dhe një Partneri Zbatues që është një organizatë, do të jetë në përputhje me këtë Marrëveshje dhe do të përfshijë një plan monitorimi dhe vlerësimi, duke përfshirë treguesit, synimet dhe rezultatet.

D. MCC

USAID dhe Qeveria njohin dhe kuptojnë se MCC ka ngarkuar USAID-in me përgjegjësinë për administrimin dhe monitorimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, sipas parimeve të MCC të pronësisë së vendit, përgjegjshmërisë dhe theksimit të rezultateve. USAID-i dhe Qeveria pranojnë dhe bien dakord që MCC nuk do të ketë të drejta ose detyrime sipas kësaj Marrëveshjeje.

V. Plani financiar

Plani financiar ("Plani financiar") në lidhje me programin është paraqitur më poshtë. Plani financiar mund të pësojë ndryshime me shkrim nga ana e Përfaqësuesve të Autorizuar pa amendim formal të Marrëveshjes, nëse këto ndryshime nuk bëjnë që kontributi i USAID-it të tejkalojë shumën e specifikuar në seksionin 3.1 të Marrëveshjes.

Komponentët e programit

Kontributi i komponentit të programit	Kontributi i USAID-it (në dollarë amerikanë)
A. Reforma e Administratës Tatimore	5 440 000 \$
B. Reforma e Prokurimit Publik	5 810 000 \$
C. Reforma e Regjistrimit të Biznesit	2 600 000 \$

Totali	13 850 000 \$
--------	---------------

VI. Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi dhe vlerësimi i programit do të bazohet në faktorë sasiorë dhe cilësorë dhe do të kryhet nga Ministria e Financave me asistencën teknike të siguruar sipas kësaj Marrëveshjeje nga Partnerët Zbatues dhe USAID-i.

Arritja e rezultateve dhe objektivit strategjik do të matet, bazuar në treguesit dhe synimet e mëposhtme të performancës.

A. Reforma e administratës tatimore

1. Rritja e taksave totale të mbledhura nga Zyra e Taksapaguesve Masivë nga 30.4 për qind në 50 për qind të taksave totale të mbledhura.

2. Krijimi i një sistemi automatik rimbursimi TVSH-je, që të jetë operacional brenda gjashtë muajve për kompensimet automatike të TVH-së për eksportuesit dhe brenda 12 muajve për rimbursimet automatike të TVSH-së ndaj të gjitha bizneseve të tjera.

3. Ulja nga 42 në 13 për qind, e përqindjes së firmave që deklarojnë mitmarrje në mbledhjen e taksave.

4. Ulja nga 53 në 25, e numrit mesatar të pagesave në vit të taksave të paguara për firmën.

B. Reforma e prokurimit publik

1. Ulja e kostos së prokurimeve qeveritare me 20 për qind (rregulluar nga volumi, monedha dhe inflacioni).

2. Ulja nga 6.15 për qind në dy për qind (si përqindje e vlerës së kontratës), e vlerës së kontributit që pritët të paguhet për të marrë një kontratë qeveritare.

3. Rritja nga zero në 2.5 për qind e prokurimeve të kryera në formë elektronike.

4. Ulja e përqindjes së firmave që thonë se mitmarrja për të përfutur kontrata qeveritare është nga 42 në 22 për qind.

C. Reforma e regjistrimit të biznesit

1. Ulja nga 60 në 30 për qind e volumit të ekonomisë informale si përqindje e prodhimit kombëtar bruto.

2. Rritja nga 625 në 1000 e numrit të bizneseve të reja të regjistruara çdo muaj.

3. Ulja nga 31 në 13 për qind e kostos së regjistrimit total si përqindje e të ardhurave për frymë.

4. Ulja nga 69 në 30 për qind e përqindjes së bizneseve që e konsiderojnë korrupsionin një pengesë të madhe në procesin e operacionalitetit dhe zhvillimit.

5. Ulja nga 19 në 5 për qind e përqindjes së bizneseve që kanë qenë objekt i mitmarrjes për regjistrim.

6. Ulja nga 47 në një e numrit të ditëve që nevojiten për të regjistruar një biznes.

7. Ulja nga 35 në 16 për qind e numrit të mitmarrjeve në marrjen e licencave dhe lejeve të biznesit.

Për më tepër, Qeveria do të monitorojë të gjitha rezultatet për të siguruar përputhshmërinë e performancës me këtë Marrëveshje.

SHTOJCA 2 DISPOZITAT STANDARDE

Neni A: Përkufizimet dhe dokumentet e zbatimit

Seksioni A.1. Përkufizimet

Siç përdoret në këtë shtojcë, "Marrëveshja" i referohet Marrëveshjes së grantit të objektivit strategjik, duke përfshirë shtojcën 1, në të cilën është bashkëngjitur kjo shtojcë dhe pjesë e së cilës është kjo shtojcë. Termat me shkronja kapitale të përdorura dhe që nuk janë përcaktuar ndryshe në këtë shtojcë kanë të njëjtën kuptim ose referencë si në Marrëveshje.

Seksioni A.2. Dokumentet e zbatimit

Për të asistuar Marrësin e Grantit në zbatimin e Marrëveshjes, USAID-i herë pas here, do të japë informacion shtesë në lidhje me çështjet e deklaruara në këtë Marrëveshje. Palët, gjithashtu mund të lëshojnë dokumente zbatimi me pëlqimin e përbashkët, për të konfirmuar dhe treguar mirëkuptimin e tyre të ndërsjellë mbi aspekte të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Dokumentet e zbatimit gjithashtu mund të lëshohen për të treguar rishikime ose përjashtime, të cilat lejohen nga Marrëveshja.

Neni B: Marrëveshje të përgjithshme

Seksioni B.1 Konsulenca

Palët do të bashkëpunojnë për të siguruar arritjen e objektivit dhe rezultateve të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, Palët, me kërkesën e secilës, do të shkëmbejnë mendime në lidhje me ecurinë drejt objektivit dhe rezultateve, performancën e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, performancën e ndonjë konsulenti, kontraktuesi ose furnizuesi të angazhuar sipas Marrëveshjes dhe çështje të tjera që kanë lidhje me Marrëveshjen.

Seksioni B.2. Ekzekutimi i Marrëveshjes. Marrësi i Grantit:

a) Do të realizojë marrëveshjen ose nxisë realizimin e saj me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe konform praktikave të shëndosha teknike, financiare dhe menaxhuese, si dhe në përputhje me ato dokumente, plane, specifikime, kontrata, programe ose rregullime të tjera dhe me ndonjë modifikim në të, miratuar nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Do të sigurojë menaxhim të kualifikuar dhe me përvojë, si dhe trajnim të stafit si të jetë më e përshtatshme për mbështetjen dhe operimin e aktiviteteve të financuara nga Marrëveshja dhe, siç është e zbatueshme për aktivitetet e vazhdueshme; do të nxisë operimin dhe mbështetjen e atyre aktiviteteve në mënyrë që të sigurojë arritjen e vazhdueshme dhe të sukseshme të objektivit dhe rezultateve të marrëveshjes.

Seksioni B.3 Shfrytëzimi i mallrave dhe shërbimeve

a) Çdo mall dhe shërbim i financuar nga kjo Marrëveshje, për sa kohë që USAID-i nuk bie dakord ndryshe me shkrim, do t'i kushtohet Marrëveshjes deri në përfundimin ose mbarimin e Marrëveshjes, dhe më pas (si dhe gjatë ndonjë periudhe pezullimi të Marrëveshjes) do të përdoret për të nxitur objektivin e Marrëveshjes dhe siç mund të urdhërojë USAID-i në dokumentet e zbatimit.

b) Mallrat ose shërbimet e financuara nga kjo Marrëveshje, përveç rasteve kur USAID mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, nuk do të përdoren për të nxitur ose asistuar një projekt ose aktivitet ndihme të huaj të shoqëruar ose financuar nga një vend që nuk është i përfshirë në Kodin Gjeografik të USAID-it 935, kur është në fuqi gjatë kohës së këtij përdorimi.

Seksioni B.4.Tatimi

a) Çlirimi nga detyrimi i përgjithshëm. Marrëveshja dhe asistenca nën të janë të çliuara nga çdo taksë e vënë sipas ligjeve në fuqi në territorin e Marrësit të Grantit.

b) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, çlirimi nga detyrimi i përgjithshëm në nënseksionin (a) zbatohet, por nuk është i kufizuar (1) ndaj çdo aktiviteti, kontrate, granti ose marrëveshjeje tjetër zbatuese të financuar nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje; (2) çdo transaksioni ose furnizimi, pajisjeje, materialesh, prone ose mallrave të tjera (më poshtë të quajtura së bashku "mallra") sipas pikës (1) më sipër; (3) çdo kontraktuesi Marrësi Granti ose organizate tjetër që kryhen aktivitete të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje; (4) çdo punonjësi të këtyre organizatave; dhe (5) çdo kontraktuesi ose Marrësi Granti individual që kryen aktivitete të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje.

c) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, çlirimi nga detyrimi i përgjithshëm në nënseksionin (a) zbatohet, por nuk është i kufizuar për taksat e mëposhtme:

1. Çlirimi nga detyrimi 1.Taksat doganore, tarifat, taksat e importit ose taksat e tjera në importimin, përdorimin dhe rieksporimin e mallrave ose sendeve personale (duke përfshirë automobilat që janë pronë private) për përdorim personal të individëve joendas ose të anëtarëve të familjeve të tyre. Përfshirimi 1 përfshin, por nuk është i kufizuar për të gjitha tarifat, bazuar në vlerën e atyre mallrave të importuara, por nuk përfshin tarifat e shërbimit të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimet e kryera për transferimin e mallrave ose ngarkesës së mallrave.

2. Çlirimi nga detyrimi 2. Taksat mbi të ardhurat, përfitimet ose pasurinë e të gjitha (i) organizatave jokombëtare të çdo lloji, (ii) punonjësit joendas të organizatave kombëtare dhe jokombëtare ose (iii) kontraktuesit dhe Marrësit e Grantit jokombëtarë individualë. Çlirimi nga detyrimi 2 përfshin të ardhurat dhe taksat e sigurimeve shoqërore të të gjitha llojeve dhe të gjitha taksat mbi pasurinë, personale ose të patundshme, të zotëruara nga ato organizata ose persona joendas. Termi "shtetas ose kombëtar" i referohet organizatave të krijuara sipas ligjeve të Marrësit të Grantit dhe shtetasve të vendit marrës të grantit, të ndryshëm nga shtetasit e huaj me banim të përhershëm në Shtetet e Bashkuara.

3. Çlirimi nga detyrimi 3. Taksat e vëna mbi transaksionin e fundit për blerjen e mallrave ose shërbimeve të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë taksat e shitjeve, tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) ose taksave mbi blerjet ose shumave të qirasë së pasurisë së patundshme ose personale. Termi "transaksion i fundit" i referohet transaksionit të fundit me anë të të cilit mallrat ose shërbimet janë blerë për përdorim në aktivitetet e financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) Nëse një taksë është vënë dhe paguar në kundërshtim me dispozitat e një çlirimi nga një detyrim, USAID, brenda fushës së veprimit të tij, mund (1) të kërkojë që Marrësi i Grantit t'i kompensojë USAID-it ose të tjerëve, kur USAID-i mund të urdhërojë sasinë e kësaj takse me fonde të ndryshme nga ato të siguruara sipas Marrëveshjes, ose (2) të kompensojë sasinë e kësaj takse nga sasinë që do të disbursohen sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjesh të tjera ndërmjet Palëve.

e) Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me aplikimin e një çlirimi nga detyrimi, Palët bien dakord të takohen menjëherë dhe t'i zgjidhin këto çështje, udhëhequr nga parimi që asistenca e dhënë nga USAID-i është e çliuar nga tatimi i drejtpërdrejtë, në mënyrë që e gjithë asistenca e dhënë nga USAID-i të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit të Marrësit të Grantit.

Seksioni B.5 Raportet dhe informacioni, librat dhe regjistrat e marrëveshjes, kontrollet financiare dhe inspektimet.

a) Raportet dhe informacioni. Marrësi i Grantit do t'i japë USAID-it regjistra llogarie dhe informacione e raporte të tjera të ngjashme në lidhje me Marrëveshjen, siç mund të kërkojë USAID-i në mënyrë të arsyeshme.

b) Librat dhe regjistrat e marrëveshjes së Marrësit të Grantit. Marrësi i Grantit do të mbajë libra llogarie, regjistra, dokumente dhe prova të tjera në lidhje me Marrëveshjen, të mjaftueshme për të treguar, pa kufizim, të gjitha kostot e shkaktuara nga Marrësi i Grantit sipas Marrëveshjes, marrjen dhe përdorimin e mallrave dhe shërbimeve të përfuara sipas Marrëveshjes nga Marrësi i Grantit, kërkesat e ndarjes së kostos të rëna dakord, natyrën dhe shkallën e kërkesave të furnizuesve të mundshëm të mallrave dhe shërbimeve të përfuara nga Marrësi i Grantit, bazën financiare të kontratave dhe urdhrave të Marrësit të grantit dhe ecurinë e përgjithshme të Marrëveshjes drejt përfundimit (“Librat dhe regjistrat e Marrëveshjes”). Marrësi i Grantit do të mbajë libra dhe regjistra të Marrëveshjes, në përputhje me parimet e kontabilitetit të pranuar gjerësisht që dominojnë në Shtetet e Bashkuara ose me opsionin e Marrësit të Grantit, me miratimin nga USAID-i, do të mbështesë parime të tjera kontabiliteti, si ato (1) të parashikuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (një degë e Federatës Ndërkombëtare të Llogaritarëve) ose (2) që dominon në vendin e Marrësit të Grantit. Librat dhe regjistrat e marrëveshjes do të mbahen për të paktën tre vjet pas datës së disbursimit të fundit nga USAID-i ose për periudhë më të gjatë, nëse ka, të kërkuar për të zgjidhur ndonjë mosmarrëveshje, pretendim ose zbulime të kontrollit financiar.

c) Kontrolli financiar i marrësit të auditit. Nëse 300 000 dollarë ose më shumë nga fondet e USAID-it, shpenzohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Marrësi i Grantit në vitin e tij fiskal sipas Marrëveshjes, Marrësi i Grantit do të nxjerrë kontrollet financiare nga shpenzimet në përputhje me kushtet e mëposhtme, përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim.

1) Me miratimin e USAID-it, Marrësi i Grantit do të përdorë institucionin e tij më të lartë të kontrollit financiar ose do të përzgjedhë një kontroll financiar të pavarur, në përputhje me “Udhëzimet për kontrollet financiare të kontraktuara nga marrësit e huaj” lëshuar nga Inspektori i Përgjithshëm i USAID-it (“Udhëzimet”) dhe kontrollet financiare do të kryhen në përputhje me “Udhëzimet” dhe

2) Kontrolli financiar do të përcaktojë nëse marrja dhe shpenzimi i fondeve të siguruar sipas Marrëveshjes janë paraqitur në përputhje me parimet e pranuar gjerësisht të kontabilitetit të rëna dakord në seksionin (b) më lart dhe nëse Marrësi i Grantit u është përmbajtur kushteve të Marrëveshjes. Çdo kontroll financiar do të përfundojë jo më vonë se nëntë muaj pas mbylljes së vitit të Marrësit të Grantit, sipas kontrollit financiar.

d) Kontrollet financiare nën marrëse. Marrësi i Grantit, përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do t’i dorëzojë USAID-it, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për USAID-in, një plan në lidhje me kontrollin financiar të shpenzimeve të nën marrësve “të mbuluar”, siç përcaktohet më poshtë, që marrin fondet sipas kësaj marrëveshjeje në bazë të një kontrate ose marrëveshjeje të drejtpërdrejtë me Marrësin e Grantit.

1. Një nën marrës “i mbuluar” është ai që shpenzon 300 000 ose më shumë dollarë në vitin e tij fiskal të “financave të USAID-it (d.m.th, si marrës të kontratave, granteve ose marrëveshjeve të bashkëpunimit të rimbursueshme të kostos së USAID-it dhe si nën marrës sipas objektivit strategjik të USAID-it e marrëveshjeve të tjera të Grantit me qeveritë e huaja).

2. Plani do të përshkruajë metodologjinë që do të përdoret nga Marrësi i Grantit për të përmbushur përgjegjësitë e tij të kontrollit financiar për nën marrësit e mbuluar. Marrësi i Grantit mund t’i përmbushë këto përgjegjësi kontrolli financiar duke u mbështetur në kontrollet e pavarura financiare të nën marrësve; duke zgjeruar fushën e aktivitetit të kontrollit të pavarur financiar të Marrësit të Grantit, për të përfshirë testimin e llogarive të nën marrësve ose një kombinim të këtyre procedurave.

3. Plani do të identifikojë fondet në dispozicion ndaj nën marrësve të mbuluar që do të mbulohen nga kontrollet financiare të kryera në përputhje me kushtet e kontrolleve të tjera financiare, të cilat do të përmbushnin përgjegjësitë e kontrollit financiar të Marrësit të Grantit. (Një organizatë joqeveritare e organizuar në Shtetet e Bashkuara i kërkohet të organizohet për kontrollet e saj financiare. Një kontraktuesi fitimprurës i organizuar në Shtetet e Bashkuara, që ka kontratë të drejtpërdrejtë me USAID-in, i bëhet kontroll financiar nga agjencia e mirinformuar e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Një organizatë private vullnetare e organizuar jashtë Shteteve të Bashkuara me një grant të drejtpërdrejtë nga USAID-i, i kërkohet të organizohet për kontrollet e saj financiare. Një kontraktues i vendit pritës duhet të auditohet nga agjencia e kontrollit financiar të Marrësit të Grantit.)

4. Marrësi i Grantit do të sigurojë që nën marrësit e mbuluar sipas kontratave ose marrëveshjeve të drejtpërdrejta me Marrësin e Grantit të marrin masa përmirësuese të përshtatshme dhe në kohë; të marrë në konsideratë nëse kontrollet financiare të nën marrësve kanë nevojë për rregullime të të dhënave të tyre; dhe nëse secili nën marrës duhet të lejojë kontrollorë të pavarur financiarë që të kenë akses në të dhënat dhe deklaratat financiare, sipas nevojës.

e) Raportet e kontrolleve financiare. Marrësi i Grantit do t’i japë ose do të nxisë dhënien ndaj USAID-it të një raporti kontrolli financiar në lidhje me çdo kontroll financiar të organizuar nga Marrësi i Grantit, në përputhje me këtë seksion brenda 30 ditëve pas përfundimit të kontrollit financiar dhe jo më vonë se nëntë muaj pas përfundimit të periudhës së kontrollit financiar.

f) Nën marrësit e tjerë të mbuluar. Për nën Marrësit “e mbuluar” të cilët marrin fonde sipas Marrëveshjes

në bazë të kontratave ose marrëveshjeve të drejtpërdrejta me USAID-in, USAID-i do të përfshijë kërkesa të përshtatshme kontrolli financiar në ato kontrata ose marrëveshje dhe në emër të Marrësit të Grantit do të kryejë aktivitete përforcuese në lidhje me raportet e kontrollit financiar, të dhëna sipas këtyre kërkesave.

g) Kostoja e kontrolleve financiare. Objekt i miratimit me shkrim nga USAID-i, kostot e kontrolleve financiare të kryera në përputhje me kushtet e këtij seksioni, mund t'i faturohen Marrëveshjes.

h) Kontrolli financiar nga USAID-i. USAID-i ka të drejtën të kryejë kontrolle financiare që kërkohen sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Marrësit të Grantit, duke përdorur fondet sipas Marrëveshjes ose burime të tjera në dispozicion të USAID-it për këtë qëllim, të kryejë rishikim financiar ose ndryshe të sigurojë përgjegjshmërinë e organizatave që shpenzojnë fondet e USAID-it, pavarësisht nga kërkesa e kontrollit financiar.

i) Mundësia për kontroll financiar ose inspektim. Marrësi i Grantit do t'u sigurojë përfaqësuesve të autorizuar të USAID-it mundësinë, në të gjitha periudhat e arsyeshme, të kryejnë kontrolle financiare ose të inspektojnë aktivitete të financuara sipas Marrëveshjes, përdorimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga USAID-i dhe libra, regjistra e dokumente të tjera në lidhje me Marrëveshjen.

j) Librat dhe regjistrat e nënmarrësve. Marrësi i Grantit do të përfshijë paragrafët a), b), d), e), g), h) dhe i) të kësaj dispozite në të gjitha nënmarrëveshjet me organizatat që nuk janë nga Shtetet e Bashkuara, të cilat plotësojnë kufirin e 300 000 dollarë të paragrafit (c) të kësaj dispozite. Nënmarrëveshjet me organizatat amerikane do të deklarojnë se organizata amerikane është objekt i kërkesave të kontrollit financiar në përmbajtje të Qarkores OMBA-133.

Seksioni B.6 Plotësimi i informacionit. Marrësi i Grantit konfirmon:

a) që faktet dhe rrethanat për të cilat është informuar USAID-i ose kanë bërë që USAID-i të informohet gjatë arritjes së marrëveshjes me USAID-in, në lidhje me Marrëveshjen, janë të sakta dhe të plota dhe përfshijnë të gjitha faktet dhe rrethanat që mund të cenojnë materialisht marrëveshjen dhe përmbushjen e përgjegjësisë sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) që do të informojë USAID-in në mënyrë koherente në lidhje me faktet dhe rrethanat e mëtejshme që mund të cenojnë materialisht ose që ka arsye të besohet se mund të cenojnë marrëveshjen ose përmbushjen e përgjegjësisë sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni B.7. Pagesa të tjera. Marrësi i Grantit konfirmon që asnjë pagesë nuk është marrë ose nuk do të merret nga ndonjë zyrtar i Marrësit të Grantit në lidhje me prokurimin e mallrave ose shërbimeve të financuara sipas Marrëveshjes, përveç tarifave, taksave ose pagesave të ngjashme të vendosura ligjërisht në vendin e Marrësit të Grantit.

Seksioni B.8. Informacioni dhe markimi. Marrësi i Grantit do t'i japë publicitetin e duhur Marrëveshjes si një program për të cilin Shtetet e Bashkuara kanë kontribuar, do të identifikojnë vendet e aktivitetit të Marrëveshjes dhe do të markojnë mallrat e financuara nga USAID-i, siç janë përshkruar në dokumentet e zbatimit.

Neni C: Dispozitat e prokurimit

Seksioni C.1 Burimi dhe origjina

a) Disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoren ekskluzivisht për të financuar kostot e mallrave dhe shërbimeve që kërkon të ketë Marrëveshja, në lidhje me mallrat, burimin dhe origjinën e tyre dhe në lidhje me furnizuesit e mallrave dhe shërbimeve, kombësinë e tyre, në vendet e përfshira në Kodin Gjeografik 935 siç janë në fuqi në kohën që janë bërë porositë ose kontratat për ato mallra ose shërbime, përveç rasteve kur USAID mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim dhe si më poshtë:

1) Kostot e transporteve oqeanike do të financohen sipas Marrëveshjes vetëm për anije nën regjistrin e flamurëve të vendeve të përfshira në Kodin Gjeografik 935. Gjithashtu, shih seksionin C.6 në lidhje me përdorimin e anijeve me flamur amerikan.

2) Vendi i Marrësit të Grantit është një burim i mundshëm për sigurimin e marinës.

b) Burimi dhe origjina e ngarkesës oqeanike dhe ajrore do të konsiderohet të jetë vendi i regjistrimit në kohën e ngarkesës të anijes oqeanike ose avionit.

c) Dispozitat në lidhje me mallrat dhe shërbimet e kufizuara dhe të papranueshme mund të sigurohen në një dokument zbatimi.

d) Transporti ajror i pasurisë ose personave të financuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në mjetet e transportit që mbajnë vërtetimin e Shteteve të Bashkuara, në masën që shërbimi nga ato mjete transporti të jetë në dispozicion sipas Aktit Amerikan të Fluturimit. Kjo kërkesë mund të përshkruhet më tej nga USAID-i në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.2. Data e pranimit. Asnjë mall ose shërbim që nuk është prokuruar sipas urdhrave ose kontratave të vendosura ose të lidhura në formë të prerë para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, nuk mund të financohet sipas Marrëveshjes.

Seksioni C.3. Planet, specifikimet dhe kontratat. Me qëllim që të ketë marrëveshje të ndërsjella për çështjet e mposhtme dhe përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim:

a) Marrësi i Grantit do t'i japë USAID-it të përgatitur:

1) Çdo plan, specifikim, prokurim ose programe ndërtimi, kontratë ose dokumentacion tjetër ndërmjet Marrësit të Grantit dhe palëve të treta, në lidhje me mallrat ose shërbimet që do financohen sipas Marrëveshjes, duke përfshirë dokumentacionin në lidhje me parakualifikimin dhe përzgjedhjen e kontraktuesve dhe kërkesën e ofertave dhe propozimeve. Modifikime materiale në këtë dokumentacion kanë të ngjarë t'i jepen USAID-it të përgatitura;

2) Ky dokumentacion do t'i jepet USAID-it i përgatitur edhe në lidhje me mallra ose shërbime, të cilat megjithëse jo të financuara sipas Marrëveshjes, konsiderohen nga USAID-i të një rëndësie të veçantë për Marrëveshjen. Aspektet e Marrëveshjes, duke përfshirë çështje sipas këtij nënseksioni (a) (2) do të identifikohen në dokumentet e zbatimit.

b) Dokumentet në lidhje me parakualifikimin e kontraktuesve dhe kërkesën e ofertave ose propozimeve për mallra dhe shërbime të financuara sipas Marrëveshjes, do të miratohen nga USAID-i me shkrim para lëshimit të tyre dhe kushtet e tyre do të përfshijnë standardet dhe treguesit e Shteteve të Bashkuara.

c) Kontratat dhe kontraktuesit e financuar sipas marrëveshjes për shërbime inxhinierike dhe shërbime të tjera profesionale, për shërbime ndërtimi dhe për shërbime të tjera të ngjashme, pajisje ose materiale siç mund të specifikohen në dokumentet e zbatimit, do të miratohen nga USAID-i me shkrim para ekzekutimit të kontratës. Modifikimet materiale në ato kontrata do të miratohen me shkrim nga USAID-i para ekzekutimit.

d) Firmat konsulente nga Marrësi i Grantit për Marrëveshjen, por jo të financuara sipas Marrëveshjes, fusha e veprimit të shërbimeve të tyre dhe ajo e personelit të tyre të caktuar për aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes, siç mund ta specifikojë USAID-i; dhe kontraktuesit e ndërtimit të përdorur nga Marrësi i Grantit për Marrëveshjen, por jo të financuar nga Marrëveshja, do të jenë të pranueshme nga USAID-i.

Seksioni C.4.Çmimi i arsyeshëm. Vetëm çmimet e arsyeshme do të paguhen për çdo mall ose shërbim të financuar, tërësisht ose pjesërisht nga Marrëveshja. Këta artikuj do të prokurohen në mënyrë të ndershme dhe në një shkallë maksimalisht praktike dhe mbi baza konkurrueshmërie.

Seksioni C.5. Njoftimi i furnizuesve të mundshëm. Për të lejuar të gjitha firmat e Shteteve të Bashkuara të kenë mundësinë të marrin pjesë në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen sipas Marrëveshjes, Marrësi i Grantit do t'i japë USAID-it këtë informacion në lidhje me këtë dhe në kohën kur USAID-i mund ta kërkojë në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.6. Ngarkesa/transporti

a) Përveç kërkesave në seksioni C.1(a), kostot e transportit oqeanik ose ajror dhe shërbime të ngjashme dërgimi mund të mos financohen nga granti, nëse kostot janë për transportin me një anije oqeanike ose avion çarter, që nuk kanë marrë miratimin paraprak të USAID-it.

b) Nëse USAID-i nuk vendos që anijet oqeanike tregtare private me flamurin e Shteteve të Bashkuara nuk janë në dispozicion me çmime të drejta dhe të arsyeshme për ato anije, ose bie dakord ndryshe me shkrim:

1) të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e tonazhit bruto të të gjitha mallrave (të llogaritura në mënyrë të ndarë për mjetet e transportit në masë për mallrat e ngurta, anije ngarkese për mallra të ngurta dhe anijet çisternë) të financuara nga USAID-i që mund të transportohen me anije oqeanike, do të transportohet me anije tregtare private me flamurin e Shteteve të Bashkuara;

2) të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e të ardhurave bruto të ngarkesës së mallrave të gjeneruara nga të gjitha ngarkesat e financuara nga USAID-i dhe të transportuara në territorin e Marrësit të Grantit në anije ngarkese për mallra të ngurta do të paguhen për ose në interes të anijeve tregtare private që mbajnë flamurin e Shteteve të Bashkuara. Përputhshmëria me kërkesat e (1) dhe (2) të këtij nënseksioni duhet të arrihet në lidhje me çdo ngarkesë të transportuar nga portet e Shteteve të Bashkuara dhe çdo ngarkesë të transportuar nga portet joamerikane, llogaritur në mënyrë të ndarë.

Seksioni C.7 Sigurimet

a) Sigurimet e marinës për mallrat e financuara nga USAID-i që duhet të transportohen për në territorin e Marrësit të Grantit mund të financohen nga kjo Marrëveshje me kusht që (1) këto sigurime të jenë vendosur në tarifën më të favorshme dhe konkurruese të mundshme; 2) këto sigurime të jenë vendosur në një vend që është autorizuar sipas seksioni C.1(a); dhe (3) tarifat më poshtë janë të pagueshme në dollarë amerikanë ose në ndonjë valutë lirisht të konvertueshme, nëse USAID-i nuk bie dakord ndryshe me shkrim.

Nëse Marrësi i Grantit (ose Qeveria e Marrësit të Grantit), me statut, dekret, rregull, rregullore ose praktikë bën dallime në lidhje me prokurimin e financuar nga USAID-i kundër çdo kompanie sigurimesh detare të autorizuar të bëjë biznes në çdo shtet të Shteteve të Bashkuara, atëherë të gjitha mallrat e ngarkuara për në territorin e Marrësit të Grantit të financuar nga USAID-i më poshtë, do të sigurohet kundër rreziqeve detare dhe çdo sigurim do të vendoset në Shtetet e Bashkuara me një kompani ose kompani të autorizuar për të bërë biznes sigurimi detar në Shtetet e Bashkuara.

b) Përveç rasteve kur USAID mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, Marrësi i Grantit do të sigurojë ose do të nxisë sigurimin që mallrat e financuara nga Marrëveshja të importuara për Marrëveshjen kundër

rreziqeve të mundshme për transitin e tyre në pikën e përdorimit të tyre sipas marrëveshjes; atëherë këto sigurime do të lëshohen në bazë të kushteve në përputhje me praktikën e shëndoshë tregtare dhe do të sigurojnë vlerën e plotë të mallrave. Çdo zhdëmtim i marrë nga Marrësi i Grantit sipas këtij sigurimi do të përdoret për të zëvendësuar ose riparuar çdo dëm material ose humbje të mallrave të siguruara ose do të përdoret për të rimbursuar Marrësin e Grantit për zëvendësimin ose riparimin e këtyre mallrave. Çdo zëvendësim i tillë do të jetë burimi dhe origjina e vendeve të listuara në Kodin Gjografik të USAID-it 935 siç është në fuqi në kohën e zëvendësimit dhe, përveç rasteve kur Palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do të jetë objekt i dispozitave të Marrëveshjes.

Seksioni C.8. Pronësia e tepërt që i përket qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Marrësi i Grantit bie dakord që kudo që të jetë e zbatueshme, pronësia personale e tepërt që i përket qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në vend të artikujve të rinj të financuar nga Granti, duhet të përdoret. Sipas Marrëveshjes, fondet mund të përdoren për të financuar kostot e përfitimit të kësaj pasurie.

Neni D. Të ndryshme

Seksioni D.1 Disbursimet. Asnjë disbursim ndaj Marrësit të Grantit nuk do të shqyrtohet sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse kërkohen disbursime për Marrësin e Grantit, disbursimet do të bëhen nëpërmjet atyre mënyrave që Palët bien dakord me shkrim ose siç parashtrohet në shtojcën 1.

Seksioni D.2. Kursi i këmbimit. Nëse fondet e siguruara sipas Marrëveshjes paraqiten në territorin e Marrësit të Grantit nga USAID-i ose çdo agjenci publike ose private për qëllime të kryerjes së detyrime të USAID-it më poshtë, Marrësi i Grantit do të bëjë këto rregullime sipas nevojës, në mënyrë që këto fonde të mund të konvertohen në monedhën lokale në kursin e këmbimit më të lartë të mundshëm, i cili në kohën që është bërë këmbimi, është i ligjshëm në vendin e Marrësit të Grantit për çdo person dhe për çdo qëllim.

Neni E. Mbarimi; zgjidhjet ligjore

Seksioni E.1 Pezullimi dhe përfundimi

a) Çdo Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në tërësinë e saj duke i dhënë Palës tjetër një njoftim me shkrim mbi bazën e 30 ditëve. USAID-i gjithashtu mund ta përfundojë këtë Marrëveshje pjesërisht duke i dhënë Marrësit të Grantit një njoftim me shkrim mbi bazën e 30 ditëve dhe ta pezullojë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, duke i dhënë Marrësit të Grantit një njoftim me shkrim. Për më tepër, USAID-i mund ta përfundojë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht duke i dhënë Marrësit të Grantit njoftim me shkrim, nëse (i) Marrësi i Grantit nuk arrin t'i përmbahet ndonjë dispozite të Marrëveshjes, (ii), ndodh diçka që USAID-i vendos se e bën të pamundur arritjen e objektivit ose rezultateve të Marrëveshjes ose programit të asistencës apo që Marrësi i Grantit do të jetë në gjendje të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, ose (iii) çdo disbursim ose përdorim i fondeve në mënyrën e shqyrtuar këtu do të ishte në shkelje të legjislacionit në lidhje me USAID-in ose grantin, qoftë për periudhën aktuale ose më pas në fuqi.

b) Përveç pagesës të cilën Palët janë të angazhuara ta bëjnë sipas angazhimeve të parevokueshme të bëra me palët e treta para këtij pezullimi ose përfundimi, pezullimi ose përfundimi i gjithë kësaj Marrëveshjeje ose pjesërisht i saj do të pezullojë (për periudhën e pezullimit) ose përfundojë, si të jetë e zbatueshme, çdo detyrim të Palëve për të siguruar burime financiare ose burime të tjera për Marrëveshjen ose për pjesën e pezulluar apo të përfunduar të Marrëveshjes, si të jetë e zbatueshme. Çdo pjesë e kësaj Marrëveshjeje, e cila nuk është pezulluar ose përfunduar, do të mbesë në fuqi të plotë.

c) Për më tepër, pas këtij pezullimi ose përfundimi të plotë ose të pjesshëm, USAID, me shpenzimet e USAID-it, mund të urdhërojë që e drejta për mallrat e financuara sipas Marrëveshjes ose sipas pjesës së zbatueshme të Marrëveshjes, të transferohet tek USAID-i nëse mallrat janë në gjendje të dërgohen.

Seksioni E.2 Kompensimet

a) Në rast të ndonjë disbursimi i cili nuk është mbështetur me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me këtë Marrëveshje ose që nuk është bërë ose përdorur në përputhje me këtë Marrëveshje, ose ka qenë për mallra apo shërbime që nuk janë përdorur në përputhje me këtë Marrëveshje, USAID-i, megjithë disponueshmërinë ose ushtrimin e çdo zgjidhjeje tjetër ligjore sipas kësaj Marrëveshjeje, mund të kërkojë që Marrësi i Grantit të kompensojë sasinë e këtij disbursimi në dollarë amerikanë ndaj USAID-it brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas marrjes së një kërkesë në lidhje me të.

b) Nëse pamundësia e Marrësit të Grantit të përmbushë ndonjë nga detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje çon në rezultatin që mallrat ose shërbimet e financuara ose mbështetura sipas Marrëveshjes nuk përdoren efektivisht në përputhje me këtë Marrëveshje, USAID-i mund të kërkojë që Marrësi i Grantit të kompensojë të gjithën ose një pjesë të sasisë së disbursimeve sipas kësaj Marrëveshjeje për ose në lidhje me këto mallra apo shërbime në dollarë amerikanë ndaj USAID-it brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas marrjes së një kërkesë në lidhje me të.

c) E drejta sipas nënseksioneve (a) ose (b) për të kërkuar vazhdimin e një kompensimi disbursimi, pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje, për një periudhë tre vjeçare pas datës së disbursimit të fundit sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) (1) Çdo kompensim sipas nënseksioneve (a) ose (b), ose (2) çdo kompensim ndaj USAID-it nga një kontraktues, furnizues, bankë ose palë tjetër e tretë në lidhje me mallrat ose shërbimet e financuara nga Marrëveshja, që ka lidhje me një çmim të paarsyeshëm ose faturim të gabuar të mallrave ose shërbimeve ose për mallrat që nuk kanë qenë në përputhje me specifikimet apo me shërbimet që ishin të pamjaftueshme, do të (A) vihen së pari në dispozicion të Marrëveshjes, në sasinë e justifikuar, dhe (b) pjesa që mbetet, nëse ka, do të zbatohet për të ulur sasinë e grantit.

e) Çdo interes ose e ardhur tjetër mbi fondet e disbursuara nga USAID-i ndaj Marrësit të Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje, para përdorimit të autorizuar të këtyre fondeve për Marrëveshjen, do t'i kthehet USAID në dollarë amerikanë nga Marrësi i Grantit, për sa kohë që USAID nuk bie dakord ndryshe me shkrim.

Seksioni E.3. Mosheqja dorë nga zgjidhjet ligjore.

Asnjë vonesë në ushtrimin e ndonjë të drejte ose zgjidhje ligjore që rrjedh për një Palë në lidhje me financimin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si një heqje dorë ndaj kësaj të drejte ose zgjidhjeje ligjore.

Seksioni E.4. Delegimi

Marrësi i Grantit bie dakord sipas kërkesës, të ekzekutojë një delegim ndaj USAID-it të veprimit që mund të lindë ndaj Marrësit të Grantit në lidhje me ose që rrjedh nga detyrimi kontraktual apo shkëlja e performancës nga një palë ndaj një kontrate të drejtpërdrejtë në dollarë amerikanë, që USAID-i ka financuar tërësisht ose pjesërisht nga fondet e dhëna nga USAID-i, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni F: Të ndryshme

Seksioni F.1. Nxitja e investimeve

a) Përveçse kur parashtrohet specifikisht në Marrëveshje ose kur USAID-i autorizon ndryshe me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër më poshtë nuk mund të përdoret për ndonjë aktivitet që përfshin nxitjen e investimeve në një vend të huaj.

b) Në rastet kur Marrësit të Grantit i kërkohet ose dëshiron të sigurojë asistencë në fushën e mësipërme ose kërkon shpjegim nga USAID-i nëse aktiviteti do të ishte në përputhje me kufizimin e parashtruar më sipër, Marrësi i Grantit duhet të njoftojë USAID-in dhe të sigurojë një përshkrim të detajuar të aktivitetit të propozuar. Marrësi i Grantit nuk duhet të procedojë më aktivitetin derisa të këshillohet nga USAID-i për ta bërë këtë.

c) Marrësi i Grantit duhet të sigurojë që punonjësit e tij dhe nënkontraktuesit dhe nënmarrësit që sigurojnë shërbime nxitje investimesh si më poshtë, të jenë në dijeni të kufizimeve të parashtruara në këtë klauzolë dhe duhet ta përfshijnë këtë klauzolë në të gjitha nënkontratat dhe nënmarrëveshjet e tjera që janë bërë më poshtë.

Seksioni F.2 Planifikimi familjar vullnetar.

Palët bien dakord që të gjitha fondet e USAID-it të siguruara sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoren në përputhje me politikën e zbatueshme të Shteteve të Bashkuara dhe kërkesat statutores në lidhje me projektet e planifikimit familjar vullnetar dhe që asnjë nga fondet e USAID-it të siguruara sipas kësaj Marrëveshjeje apo mallrat apo shërbimet e financuara nga këto fonde, nuk mund të përdoret për:

a) kryerjen e abortit si një metodë të planifikimit familjar ose për të motivuar apo shtrënguar ndonjë person të praktikojë aborte;

b) kryerjen e sterilizimeve të pavullnetshme si një metodë të planifikimit familjar ose të shtrëngoje apo të sigurojë çdo stimul financiar ndaj çdo personi për të bërë sterilizime, ose

c) çdo kërkim biomjekësor që ka lidhje, tërësisht ose pjesërisht, me metodat ose kryerjen e aborteve apo sterilizimeve të pavullnetshme si një metodë planifikimi familjar.

USAID-i do të përgatitë dokumente zbatimi që përshkruajnë në mënyrë më të plotë kërkesat e këtij seksioni.

Seksioni F.3. Ndalimi mbi asistencën ndaj trafikantëve të drogës.

USAID-i rezervon të drejtën ta përfundojë këtë Marrëveshje ose të marrë masa të tjera të përshtatshme nëse Marrësi i grantit ose një individ kryesor i Grantit rezulton të jetë i dënur për një vepër penale në lidhje me lëndët narkotike ose që është përfshirë në trafikun e drogës siç përcaktohet në 22 Kodin e Rregulloreve Federale (CFR) Pjesa 140.

Seksioni F.4 Të drejtat e punëtorëve

a) Përveçse kur parashtrohet specifikisht në Marrëveshje ose kur USAID-i autorizon ndryshe me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër e siguruar si më poshtë nuk mund të përdoret për ndonjë aktivitet që përfshin të drejtat e punëtorëve në një vend të huaj.

b) Në rastet kur Marrësit të Grantit i kërkohet ose dëshiron të sigurojë asistencë në fushën e mësipërme ose kërkon shpjegim nga USAID-i, nëse aktiviteti do të ishte në përputhje me kufizimin e parashtruar më sipër, Marrësi i Grantit duhet të njoftojë USAID-in dhe të sigurojë një përshkrim të detajuar të aktivitetit të propozuar. Marrësi i grantit nuk duhet të procedojë me aktivitetin derisa të këshillohet nga USAID-i për ta bërë këtë.

c) Marrësi i Grantit duhet të sigurojë që punonjësit e tij dhe nënkontraktuesit dhe nënmarrësit që sigurojnë shërbime në lidhje me punësimin si më poshtë, të jenë në dijeni të kufizimeve të parashtruara në këtë

klauzolë dhe duhet ta përfshijnë këtë klauzolë në të gjitha nënkontratat dhe nën marrëveshjet e tjera që janë bërë më poshtë.

VENDIM
Nr.42, datë 19.6.2006

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006, si dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Bujar Nepravishta emërohet Kryetar i Bordit të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.43, datë 19.6.2006

PËR LARGIMIN NGA DETYRA TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Franc Zhupa largohet nga detyra e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës.

II. Zoti Rajmond Cimbi largohet nga detyra e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës.

III. Zonja Teuta Shkenza largohet nga detyra e anëtares së Komisionit të Konkurrencës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.44, datë 19.6.2006

PËR MOSLARGIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Lush Përpali qëndron në detyrë si anëtar i Komisionit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.382, datë 14.6.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të pikës 2, dhe të paragrafit të parë të pikës 3, të nenit 9 dhe të nenit 83 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shtetet e përcaktuara në lidhjen nr.8, “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, me karta identiteti, duke paguar taksën e hyrjes:

Vendet anëtare të Bashkimit Europian, Britania e Madhe, Islanda, Norvegjia, San Marino, Zvicra, Australia, Kanadaja, SHBA-ja, Zelanda e Re.”.

b) Në listën “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaporta të thjeshta), të shtohen shtetet:

“Andorra, Argjentina, Monako, Selia e Shenjtë, Singapori.”.

c) Pas kësaj pike, të shtohet një pikë tjetër, me këtë përmbajtje:

“Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë me grupe turistike, të organizuara nëpërmjet agjencive turistike, të cilët më parë kanë mbërritur për qëllime vizite në vendet e rajonit me kufi tokësor me Republikën e Shqipërisë, duke marrë në kufi vizë të shkurtër kolektive 72-orëshe, kundrejt pagesës:

Bahreini, Bolivia, Brazili, Brunei, Ekuadori, Hong Kongu, Hondurasi, Guatemala, Kili, Kosta Rika, Meksika, Moldavia, Nikaragua, Panamaja, Paraguaj, Peruja, Rusia, Salvadori, Tailanda, Taivani, Ukraina, Uruguai, Venezuela, Xhamaika.”.

2. Pas pikës 7, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Kur agjencitë turistike organizojnë grupe turistike me turistë të huaj, nga vende, shtetasit e të cilave duhet të pajisen me vizë pranë përfaqësive, diplomatike ose konsullore, të Republikës së Shqipërisë dhe udhëtojnë drejtpërdrejt nga vendi i tyre për në Shqipëri, kërkesa për vizë, e bërë nga agjencitë turistike pranë këtyre përfaqësive do të trajtohet me procedurë të përshpejtuar. Procedurë të përshpejtuar në këtë rast, përbën trajtimi me përparësi i grupit, në kufijtë minimalë të kohës.

Agjencitë turistike të udhëtimit paraqesin pranë përfaqësive të Republikës së Shqipërisë listën emërore të anëtarëve të grupit turistik, ku të shënohen edhe shtetësia e numri i pasaportës, sipas formularit të dhënë nga përfaqësia, gjenealitetet e agjencisë turistike, të huaj, nëse një e tillë organizon udhëtimin e tyre në vendin e rezidencës së turistëve, si dhe programin e turit në Shqipëri.”.

3. Pas pikës 8, shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Grupet turistike, të organizuara nëpërmjet agjencive turistike, trajtohen me procedurë të përshpejtuar në kufi. Agjencitë turistike të udhëtimit paraqesin pranë drejtorisë vendore të policisë kërkesën zyrtare me vulë, të shoqëruar me listën emërore të anëtarëve të grupit turistik, ku është shënuar shtetësia dhe numri i pasaportës, sipas formularit të përcaktuar nga policia e kufirit dhe emigracionit, gjenealitetet e agjencisë

turistike të huaj, nëse një e tillë bën shoqërimin e tyre deri në kufi, si dhe programin e turit në Shqipëri. Kjo listë i dërgohet drejtorisë vendore të policisë, si dhe pikës së kalimit të kufirit ku do të kryhet lëvizja, nëpërmjet fax-it ose e-mail-it, jo më vonë se 48 orë para mbërritjes së grupit, me qëllim marrjen e masave për regjistrimin paraprak të grupit turistik, i cili do të trajtohet me procedurë të përsheptuar nga policia e pikës së kalimit kufitar, në çastin e mbërritjes.

Procedurë e përsheptuar vlerësohet dhënia e vizës kolektive për rastet e caktuara në lidhjen nr.8 dhe/ose verifikimi vetëm i listës së grupit turistik, të paraqitur nga agjencia turistike, me praninë e turistëve në autobus, dhe kontrolli i pasaportave, në çastin e mbërritjes në pikën e kalimit të kontrollit kufitar. Pas verifikimit të listës lejohet lëvizja e grupit turistik për të mos krijuar vonesë. Regjistrimi i turistëve bëhet në bazë të listës së dërguar më parë, jo në prani të grupit turistik.

Grupi turistik përbëhet prej jo më pak se dy personash, lista e të cilit deklarohet nga agjencia turistike.”. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.384, datë 14.6.2006

PËR LEJIMIN E HYRJES DHE TË QËNDRIMIT TË PËRKOHSHËM NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË TRUPAVE BRITANIKE, PJESEMARRËSE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT “ALBANIA EXPRESS 06”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes e të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e hyrjes dhe të qëndrimit të përkohshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, për periudhën 28.6.2006-16.7.2006, të 140 (njëqind e dyzet) trupave ushtarake britanike, pjesëmarrëse në stërvitjen e përbashkët “Albania Express 06”, që do të zhvillohet në vendin tonë.
 2. Mbërritja e trupave britanike në vendin tonë të bëhet me dy rejse:
 - Rejsi i parë (pararoja), më 28 qershor 2006.
 - Rejsi i dytë (trupat kryesore), më 1 korrik 2006.
 3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.385, datë 14.6.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, PËR HAPJEN E PIKËS SË RE TË KALIMIT KUFITAR RRUGOR NDËRKOMBËTAR, MIDIS DY VENDEVE XHEPISHT-TREBISHT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për hapjen e pikës së re të kalimit kufitar rrugor ndërkombëtar, midis dy vendeve, Xhepisht-Trebisht.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR HAPJEN E PIKËS SË RE TË KALIMIT KUFITAR RRUGOR NDËRKOMBËTAR MIDIS DY VENDEVE, “XHEPISHT-TREBISHT”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në tekstin e mëposhtën “palët në marrëveshje”,

duke pasur parasysh marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë mes dy shteteve,
duke pasur parasysh dëshirën për një forcim dhe zhvillim të mëtejshëm të bashkëpunimit me dobi të ndërsjellë, si dhe dëshirën për krijimin e kushteve të favorshme maksimale për zhvillimin e tij,
duke pasur parasysh synimin për realizimin e vendimit për përmirësimin e infrastrukturës të transportit evropian dhe rajonal,
si konfirmim të marrëveshjeve të arritura tashmë në nivelin politik të lartë,
ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët në Marrëveshje, brenda një afati, për të cilin do të merren vesh institucionet përkatëse, do të ndërtojnë dhe hapin pikëkalimin kufitar rrugor ndërkombëtar të ri dhe lidhjen rrugore, që do të lidhin Trebishtin në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Xhepishtën në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 2

Secila nga palët në marrëveshje do të ndërtojë, rikonstruktojë dhe modernizojë në territorin e vet një rrjet rrugor të kalueshëm. Secila nga palët do të ndërtojë infrastrukturën e domosdoshme për funksionimin e pikëkalimit kufitar ndërkombëtar të ri për nevojat e shërbimit të udhëtarëve dhe të të gjitha llojeve të mallrave. Për përmasat e objekteve dhe standardet, përta i përket lidhjes rrugore mes pikëkalimeve kufitare, do të bihet dakord në seancat e Komisionit të Përbashkët të Ekspertëve (në tekstin e mëposhtëm KPE).

Vendet e sakta të kalimit të kufirit dhe vendndodhja e saktë e pikëkalimit kufitar rrugor të ri, si dhe parametrat teknikë të tij, do të përcaktohen nga KPE-ja.

Neni 3

Palët në marrëveshje do të krijojnë Komisionin e Përbashkët të Ekspertëve (KPE) që do të përcaktojë karakteristikat teknike bazë të lidhjeve rrugore, vendndodhjen e rrugëve, pikat e kalimit nga ato të kufirit, vendndodhjen e pikëkalimit kufitar rrugor ndërkombëtar të ri, infrastrukturën, stacionet, llojet e mallrave dhe të udhëtarëve, regjimin e funksionimit, çështjet juridike e normative lidhur me ndërtimin e pikë kalimit kufitar rrugor ndërkombëtar dhe të gjitha çështjet me interes të përbashkët, që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

KPE-ja, në takimin e parë të punës, do të harmonizojë dhe, në seancën e radhës, do të miratojë rregulloren e punës.

KPE-ja do të hartojë dhe do të marrë vendime në përputhje me udhëzimet e qeverive të të dy vendeve.

Palët në marrëveshje bien dakord që takimet e KPE-së të mbahen, në mënyrë alternative, në Tiranë dhe në Shkup.

Brenda një afati prej 30 ditësh, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, në rrugë diplomatike, do të shkëmbehen listat me emrat dhe funksionet e anëtarëve të KPE-së të cilët, gjatë muajit pasardhës pas informimit të ndërsjellë, do të mbajnë takimin e parë të punës.

Neni 4

Mosmarrëveshjet rreth interpretimit dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nga KPE-ja. Në rat se, brenda një afati prej tre muajsh, KPE-ja nuk do të mund të gjejë një zgjidhje të pranuar nga të dyja palët, mosmarrëveshjet, do të zgjidhen përmes bisedimeve mes dy qeverive, deri në fund të muajit pasardhës.

Neni 5

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e marrjes së notës së dytë, me të cilën palët në marrëveshje informojnë njëra-tjetrën se janë përmbushur të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionet kombëtare të tyre.

Marrëveshja u nënshkrua në Tiranë, më 16 nëntor 2005, në dy ekzemplarë origjinalë në gjuhët shqipe dhe maqedonase, ndërsa të dy tekstet kanë vlefshmëri të barabartë.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 29.6.2006
Doli nga shtypi më 1.7.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë